



USHTRIA




Viti i 82-të i botimit Nr. 20 (827976)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 22 maj 2026

“FORCAT SPECIALE SHQIPTARE *mishërojnë shpirtin luftarak të heroit shqiptar,* SKËNDERBEUT”



» faqe 5



MINISTRI NUFI VIZITON BAZËN E MBËSHTETJES PËR EMERGJENCAT CIVILE

Forcimi i kapaciteteve dhe gatishmëria operationale, në fokus të përballimit të emergjencave. Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, zhvilloi një vizitë në Bazën e Mbrojtjes për Emergjencat Civile (BMEC), ku u takua me efektivet e Forcave të Armatosura të angazhuar çdo ditë në mbështetje të komunitetit dhe përballimin e situatave emergjente, me fokus të veçantë reagimin ndaj zjarreve gjatë sezonit veror. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm...

faqe 3



ANGAZHIMI SHQIPTAR PËR SIGURINË KOLEKTIVE NË FOKUS TË NATO-S

Gjeneralletjënant Arben Kingji zhvillon takime të rëndësishme në Bruksel. Në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel u zhvillua takimi i Komitetit Ushtarak të Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të Aleancës, një nga forumet më të rëndësishme strategjike për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive në hapësirën euroatlantike. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë...

faqe 2



“HISTORIA NUK DUHET TË HESHTË NË ARKIVA, POR TË JETOJË NË KUJTESËN E KOMBIT”

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një kohë kur ritmi i shpejtë i zhvillimeve globale dhe teknologjia moderne shpesh e largojnë shoqërinë nga reflektimi mbi të kaluarën, muzetë mbeten ndër institucionet më të rëndësishme të kujtesës kombëtare. Ato janë ura që lidhin brezat me historinë, sakrificat, kulturën dhe identitetin e një populli...

faqe 6

Gjenerallejtënant Arben Kingji zhvillon takime të rëndësishme në Bruksel

Në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel u zhvillua takimi i Komitetit Ushtarak të Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të Aleancës, një nga forumet më të rëndësishme strategjike për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive në hapësirën euroatlantike.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili zhvilloi një sërë takimesh dhe konsultimesh me homologë të vendeve aleate dhe partnere.

Në fokus të diskutimeve të Komitetit Ushtarak ishin forcimi i mbrojtjes kolektive dhe kapaciteteve parandaluese të NATO-s, zhvillimi i kapaciteteve ushtarake të Aleancës, situata strategjike e sigurisë në krahun lindor dhe jugor, bashkëpunimi me Ukrainën dhe Bashkimin Europian, si dhe përgatitjet për Samitin e ardhshëm të NATO-s që do të zhvillohet në muajin korrik në Ankara.

Gjatë punimeve të forumit, Gjenerallejtënant Arben Kingji ritheksoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për ruajtjen e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, duke nënvizuar rolin aktiv të vendit tonë si anëtar i përgjegjshëm dhe kontribuues në strukturat e Aleancës Atlantike.

Në kuadër të takimeve dypalëshe, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së zhvilloi një takim edhe me gjeneralin Carsten Breuer, ku në qendër të bisedimeve ishte forcimi i ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave të Armatosura të dy vendeve, zgjerimi i bashkëpunimit ushtarak dhe rritja e nivelit të stërvitjeve të përbashkëta.

Takimi në Bruksel konfirmoi edhe njëherë rolin e Shqipërisë si partner i besueshëm në NATO dhe angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në përballimin e sfidave të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Gjatë këtij takimi u diskutua gjithashtu mbi rëndësinë e misionit KFOR për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, si një element kyç për sigurinë rajonale dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit.

Një tjetër takim i rëndësishëm u zhvillua edhe me Miodrag Vuksanovic, ku u theksua nevoja për rritjen e bashkëpunimit ushtarak bilateral dhe rajonal, si dhe koordinimin më të ngushtë në kuadër të strukturave të NATO-s.

Takimet dhe diskutimet e zhvilluara në Bruksel konfirmuan edhe një herë rolin aktiv të Shqipërisë në arkitekturën euroatlantike të sigurisë dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për të kontribuar në paqen, stabilitetin dhe mbrojtjen kolektive të Aleancës.



Angazhimi shqiptar për sigurinë kolektive në fokus të NATO-s



Forca Ajrore mbështet stërvitjen “Mburoja e Arbrit”

Helikopterët “Cougar” dhe “Black Hawk” realizojnë transportin ajror të trupave të Forcës Tokësore

Forca Ajrore vijon mbështetjen ndërstrukturore në kuadër të stërvitjeve të përbashkëta të Forcave të Armatosura, duke kontribuar në rritjen e gatishmërisë operacionale dhe ndërveprimit ndërmjet strukturave ushtarake.

Pas angazhimit në stërvitjen e Forcës Detare “Redoni Goditës 26”, Forca Ajrore mbështeti edhe zhvillimin e stërvitjes së Forcës Tokësore “Mburoja e Arbrit”, përmes realizimit të transportueshmërisë ajrore të trupave të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë të Regjimentit të Këmbëorisë së Jugut.

Me angazhimin e helikopterëve “Cougar” dhe “Black Hawk”, rreth 200 efektivë u trajnuan për herë të parë mbi procedurat e transportit ajror, reagimit operacional dhe koordinimit në terren, në funksion të rritjes së aftësive operacionale dhe përgatitjes së përbashkët të strukturave të Forcave të Armatosura.

Stërvitja shërbeu për testimin dhe përmirësimin e procedurave të ndërveprimit ndërmjet Forcës Ajrore dhe Forcës Tokësore, duke evidentuar rëndësinë e koordinimit dhe reagimit të shpejtë në operacione të ndryshme ushtarake dhe emergjente.

Angazhimi i Forcës Ajrore në këto aktivitete konfirmon rolin e saj të rëndësishëm në mbështetjen operacionale të strukturave të tjera të FA-së, si dhe përkushtimin për rritjen e kapaciteteve të përbashkëta sipas standardeve të NATO-s.



Forca Tokësore në mbështetje të edukimit ushtarak

Regjimenti i Këmbëorisë së Veriut mirëpret pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Oficerit

Vau i Dejës – Regjimenti i Këmbëorisë së Veriut i Forcës Tokësore (RKVFT) mirëpriti pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), në kuadër të bashkëpunimit institucional për edukimin dhe përgatitjen profesionale të efektivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Takimi njohës shërbeu për prezantimin e misionit, organizimit, kapaciteteve operacionale dhe rolit të Regjimentit të Këmbëorisë së Veriut, si një ndër strukturat më të rëndësishme të Forcës Tokësore në përbushjen e detyrave të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Gjatë vizitës, pjesëmarrësit u njohën nga afër me aktivitetin operacional dhe stërvitor të regjimentit, si dhe me përvojën profesionale të personelit ushtarak në përballimin e detyrave dhe sfidave të ndryshme në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale.

Mikpritja dhe profesionalizmi i komandës dhe shtabit të Regjimentit të Këmbëorisë së Veriut pasqyruan vlerat më të mira të institucionit ushtarak, përkushtimin ndaj detyrës dhe rëndësinë që Forca Tokësore i kushton edukimit ushtarak dhe formimit të liderëve të ardhshëm.

Në fokus të bashkëbisedimeve ishte edhe rëndësia e ndërthurjes së përvojës praktike me formimin akademik, si një element thelbësor në përgatitjen e oficerëve të rinj dhe rritjen e kapaciteteve drejtuese të Forcave të Armatosura.

Forca Tokësore mbetet e angazhuar në mbështetjen e sistemit të arsimit ushtarak, duke kontribuar në përgatitjen profesionale, zhvillimin e leadershipit dhe forcimin e standardeve bashkëkohore të edukimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Forcimi i kapaciteteve dhe gatishmëria operacionale, në fokus të përballimit të emergjencave

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, zhvilloi një vizitë në Bazën e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC), ku u takua me efektivistët e Forcave të Armatosura të angazhuar çdo ditë në mbështetje të komunitetit dhe përballimin e situatave emergjente, me fokus të veçantë reagimin ndaj zjarreve gjatë sezonit veror.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako, si dhe gjeneralë, oficerë, nënoficerë dhe punonjës të BMEC.

Gjatë fjalës së tij, ministri Nufi theksoi angazhimin maksimal të institucioneve për forcimin e kapaciteteve në funksion të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së gatishmërisë operacionale dhe garantimit të një reagimi të shpejtë dhe efektiv në mbështetje të qytetarëve.

“Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar mbledhjet e Komisioneve të Mbrojtjes Civile në të gjitha qarqet e vendit, me fokus të veçantë masat parandaluese, identifikimin e zonave me rrezikshmëri të lartë, përditësimin e planeve të reagimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai bëri të ditur se është rritur ndjeshëm mbështetja për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me një financim prej rreth 800 milionë lekësh për vitin 2025 dhe mbi një miliard lekë për vitin 2026, në funksion të përmirësimit të kapaciteteve të mbrojtjes civile dhe reagimit emergjent.

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje gjithashtu se strukturat operacionale tashmë janë të pajisura me mjete moderne për përballimin e operacioneve emergjente, veçanërisht për menaxhimin e situatave të zjarreve.

Në fjalën e tij, ministri Nufi nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si institucioni përgjegjës për koordinimin e sistemit të mbrojtjes civile në nivel kombëtar, si dhe për bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe Mekanizmin European të Mbrojtjes Civile.

Në prag të sezonit veror, ministri i Mbrojtjes apeloi për më shumë përgjegjësi dhe ndërgjegjësim nga ana e qytetarëve, duke theksuar rëndësinë e parandalimit dhe raportimit në kohë të çdo rreziku.

“Mbrojtja civile nuk është detyrë vetëm e forcave të angazhuara në terren, por një përgjegjësi kolektive e të gjithë qytetarëve. Së bashku ndërtojmë më shumë siguri dhe garantojmë mbrojtjen e jetës dhe të vendit tonë”, -

Kreu i Shtetit vlerëson rëndësinë e edukimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, priti në një takim të veçantë pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, program që zhvillohet në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, si pjesë e formimit strategjik dhe profesional të drejtuesve civilë dhe ushtarakë në fushën e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve të sigurisë kombëtare, strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe pjesëmarrës nga vende aleate dhe partnere, ndër to Bullgaria, Greqia, Turqia, Italia, Hungaria, Kroacia, Kosova, Polonia dhe Jordania.

Gjatë takimit, Presidenti Begaj vlerësoi rëndësinë e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, duke e cilësuar atë si një ndër programet më të rëndësishme që ofron sistemi arsimor ushtarak shqiptar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kreu i Shtetit përgëzoi drejtuesit dhe stafin akademik të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për organizimin dhe zhvillimin e këtij programi, duke theksuar se edukimi strategjik dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet profesionistëve civilë dhe ushtarakë përbëjnë një element kyç në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe partneriteteve ndërkombëtare.

Presidenti Begaj nënvizoi se fryma e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet pjesëmarrësve kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e besimit reciprok dhe në përballimin më efektiv të sfidave të përbashkëta të

Ministri Nufi viziton Bazën e Mbështetjes për Emergjencat Civile



deklaroi ministri Nufi.

Në përfundim të vizitës, ministri shprehu mirënjohje për efektivistët e Bazës së Mbështetjes për Emergjencat Civile, duke vlerësuar gatishmërinë, profesionalizmin, përkushtimin dhe sakrificën e tyre në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Gjatë aktivitetit u prezantuan edhe kapacitetet operacionale dhe logjistike të BMEC, ndër të cilat mjete zjarrfikëse dhe operacionale, pajisje personale mbrojtëse për efektivistët në terren, Qendra e Lëvizshme Operacionale e Mbrojtjes Civile, dronë me kamera termike për monitorimin dhe identifikimin e vatrave të zjarrit, si dhe helikopterë të pajisur me sistemin “Bambi Bucket” për ndërhyrje ajrore në rastet e zjarreve masive.

Vizita konfirmoi angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për forcimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe rritjen e kapaciteteve të reagimit në përballimin e emergjencave në të gjithë territorin e vendit.

Presidenti Begaj pret pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen



sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Në fjalën e tij, Kreu i Shtetit vuri në dukje edhe rëndësinë e krijimit të lidhjeve të qëndrueshme profesionale ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve dhe vendeve pjesëmarrëse, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si një vlerë të shtuar për forcimin e stabilitetit, sigurisë

dhe partneritetit strategjik ndërkombëtar. Takimi u zhvillua në një atmosferë bashkëpunimi dhe shkëmbimi profesional, duke reflektuar rëndësinë që Shqipëria i kushton edukimit të avancuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe rolin aktiv të vendit tonë në strukturat euroatlantike dhe partneritetet ndërkombëtare.

Siguria e Evropës Juglindore në fokus të leksionit akademik të KLSM-16

Ambasadori i Turqisë në Tiranë, leksion për sfidat e sigurisë dhe zhvillimet gjeopolitike në rajon

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-16), pjesëmarrësit ndoqën me interes të veçantë leksionin me temë: **“Siguria e Evropës Juglindore dhe Siguria Evropiane nga perspektiva e Republikës së Turqisë”**.


I ftuar nderi në këtë aktivitet akademik ishte Shkëlqesia e Tij, Barış Ceyhan Erciyes, Ambasador i Republikës së Turqisë në Tiranë, i cili paraqiti një analizë të thelluar mbi sfidat aktuale të sigurisë, zhvillimet gjeopolitike në rajonin e Evropës Juglindore dhe rëndësinë e bashkëpunimit strategjik në ruajtjen e stabilitetit dhe pages.

Gjatë leksionit u trajtuan çështje që lidhen me arkitekturën e sigurisë europiane, sfidat rajonale, rolin e NATO-s dhe partneritetet strategjike në përballimin e kërcënimeve bashkëkohore ndaj sigurisë ndërkombëtare.

Ambasadori Erciyes vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet vendeve aleate dhe partnerëve strategjikë në forcimin e stabilitetit rajonal, duke theksuar gjithashtu rolin e dialogut dhe diplomacisë në adresimin e sfidave të reja të sigurisë.

Pjesëmarrësit e KLSM-16 u angazhuan në diskutime profesionale dhe shkëmbim idesh mbi temat e trajtuara, duke e kthyer aktivitetin në një platformë të vlefshme akademike dhe profesionale për zgjerimin e njohurive në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Leksioni u vlerësua si një kontribut me rëndësi në formimin profesional të pjesëmarrësve dhe në pasurimin e perspektivës strategjike mbi zhvillimet aktuale të sigurisë në rajon dhe më gjerë.



Kompania EOD në mbështetje të autoriteteve civile

Batalioni i Xhenios vijon operacionet për identifikimin dhe trajtimin e municioneve luftarake

Tiranë, Elbasan, Librazhd – Kompania EOD e Batalionit të Xhenios është angazhuar në mbështetje të autoriteteve civile në disa zona të vendit, në kuadër të operacioneve për identifikimin, sigurimin dhe trajtimin e municioneve luftarake të gjetura në terren.

Ekspertët EOD, duke zbatuar procedurat standarde të sigurisë dhe protokollet teknike përkatëse, realizuan kontroll vizual dhe kontrolle me aparate metalkërkuese në zonat e raportuara në bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Librazhd.

Gjatë operacionit u identifikuan dhe u vlerësuan municione luftarake të kalibrave të ndryshëm, të cilat përbënin rrezik potencial për jetën e qytetarëve dhe sigurinë e komunitetit.

Pas identifikimit, specialistët e Kompanisë EOD vijuan me transportimin dhe trajtimin e municioneve në ambientet përkatëse, në përputhje me standardet e sigurisë dhe procedurat operative të Forcave të Armatosura.

Angazhimi i Batalionit të Xhenios në këto operacione konfirmon edhe njëherë rolin e rëndësishëm të Forcave të Armatosura në mbështetje të autoriteteve civile dhe komunitetit, veçanërisht në rastet që lidhen me eliminimin e rreziqeve nga municionet e pashpërthyer.

Batalioni i Xhenios vijon përmbushjen e misionit të tij, duke garantuar siguri për jetën, pronën dhe komunitetin në të gjithë territorin e vendit.



Forcat Speciale shqiptare në stërvitjen shumëkombëshe “Trojan Footprint-26”

Efektivët elitë të FA-së stërviten krah për krah me aleatët e NATO-s në Greqi

Forcat Speciale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë po marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe të NATO-s “Trojan Footprint-26”, e cila po zhvillohet në Greqi me pjesëmarrjen e njësisve elitare nga vendet anëtare të Aleancës dhe partnerët strategjikë.

Stërvitja ka në fokus rritjen e ndërveprimit operacional ndërmjet forcave speciale, reagimin ndaj kërcënimeve moderne të sigurisë dhe koordinimin e operacioneve në mjedise komplekse operationale.

Gjatë aktivitetit stërvitor, efektivët shqiptarë po zhvillojnë trajnime të avancuara në skenarë të ndryshëm taktikë, duke testuar aftësitë operationale, gatishmërinë dhe koordinimin me strukturat partnere të NATO-s.

Pjesëmarrja në “Trojan Footprint-26” përbën një tjetër dëshmi të angazhimit të Shqipërisë në strukturat e Aleancës Atlantike dhe të rolit aktiv të Forcave të Armatosura Shqiptare në stërvitjet dhe operacionet shumëkombëshe.

Forcat Speciale shqiptare po demonstrojnë nivel të lartë profesionalizmi, disipline dhe përgatitjeje, duke operuar krah për krah me aleatët në përmbushjen e misioneve dhe objektivave të përbashkëta të NATO-s.

Kjo stërvitje shërben gjithashtu për shkëmbimin e eksperiencave, rritjen e kapaciteteve operationale dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, në funksion të përballimit të sfidave bashkëkohore të sigurisë.

Përmes angazhimit në stërvitje të tilla ndërkombëtare, Forcat Speciale shqiptare vijnë të konsolidojnë standardet profesionale dhe



ndërveprueshmërinë sipas kërkesave të NATO-s, duke konfirmuar gatishmërinë për të kontribuar në çdo teatër operational në mbështetje të pages dhe sigurisë kolektive.

FORCAT SPECIALE SHQIPTARE NË VËMENDJEN E UASHINGTONIT

“Mishërim i shpirtit luftarak të Skënderbeut”

Deklarata e të nominuarit për ambasador të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Eric Wendt, para Senatit amerikan, nuk ishte thjesht një vlerësim diplomatik rutinë. Ishte një mesazh me peshë strategjike, politike dhe historike për Shqipërinë, Forcat e saj të Armatosura dhe rolin që vendi ynë ka fituar në arkitekturën euroatlantike të sigurisë.

Kur një gjeneral amerikan deklaroi se “Forcat speciale shqiptare mishërojnë shpirtin luftarak të heroit shqiptar, Skënderbeut”, kjo nuk përbën vetëm një kompliment ceremonial. Është një njohje e drejtpërdrejtë e profesionalizmit, sakrificës dhe reputacionit që ushtarakët shqiptarë kanë ndërtuar në dekada bashkëpunimi me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara.

SHQIPËRIA, NJË ALEAT I BESUAR

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, besimi nuk ndërtohet me deklarata, por me prova konkrete në terren. Shqipëria i ka dhënë këto prova.

Nga Afganistani në Irak, nga Bosnja në Kosovë, ushtarakët shqiptarë kanë shërbyer përkrah forcave aleate me dinjitet, disiplinë dhe përkushtim. Ata nuk kanë qenë thjesht pjesëmarrës simbolikë në misione, por kontribuues realë në operacionet e sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Forcat speciale shqiptare janë ndër strukturat më të vlerësuara për nivelin e gatishmërisë, aftësitë taktike dhe përshtatshmërinë në operacione komplekse. Pikërisht ky standard profesional ka bërë që ato të fitojnë respektin e partnerëve strategjikë amerikanë.

Deklarata e Eric Wendt është një refleksion i këtij realiteti.

SKËNDERBEU SI SIMBOL USHTARAK DHE IDENTITAR

Përmendja e Skënderbeut në një forum amerikan nuk është rastësi.

Figura e Heroit Kombëtar vazhdon të mbetet simboli më përfaqësues i rezistencës shqiptare, i qëndresës ndaj pushtimit dhe i identitetit evropian të kombit shqiptar.

Kur forcat speciale shqiptare krahasohen me shpirtin luftarak të Skënderbeut, në fakt vlerësohen disa elementë themelorë: trimëria në situata të vështira;

besnikëria ndaj aleatëve, aftësia për të përballuar sfida disproporcionale, disiplina dhe vendosmëria, kultura e sakrificës për liri dhe siguri. Ky është një vlerësim që lidh historinë me aktualitetin. Një urë simbolike mes epopesë së shekullit XV dhe ushtarakut shqiptar modern që shërben sot nën flamurin e NATO-s.

FORCAT SPECIALE SHQIPTARE, NGA TRADITA TE MODERNIZIMI

Transformimi i Forcave të Armatosura Shqiptare pas anëtarësimit në NATO është një nga proceset më të rëndësishme të shtetit shqiptar në dekadat e fundit.

Në këtë transformim, Forcat Speciale kanë qenë një histori suksesi.

Trajnimet me partnerët amerikanë, standardizimi sipas doktrinaeve të NATO-s, pjesëmarrja në stërvitje ndërkombëtare dhe eksperiencia në misione reale kanë krijuar një elitë ushtarake moderne, profesionale dhe të aftë për të operuar në çdo ambient operacional.

Sot, ushtaraku shqiptar nuk përfaqëson vetëm vendin e tij. Ai përfaqëson standardet e Aleancës Atlantike.

Kjo është arsyeja pse Shqipëria konsiderohet një partner i besueshëm në rajon.

NJË MESAZH PËR SHQIPTARËT


Eric Wendt nuk foli vetëm për ushtrinë. Ai foli edhe për popullin shqiptar, duke e cilësuar “krenar, punëtor dhe mikpritës”.

Ky përkufizim ka një domethënie të veçantë në diplomaci. Ai tregon se Shqipëria nuk shihet më si një vend periferik i Ballkanit, por si një shoqëri me potencial, me aleancë të fortë me Perëndimin dhe me identitet të qartë strategjik.

Mikpritja shqiptare, besa, respekti për aleatin dhe kultura e qëndresës janë elementë që vazhdojnë të vlerësohen ndërkombëtarisht.

Në shumë raste, ushtarakët shqiptarë kanë qenë ambasadorët më të mirë të vendit në arenën ndërkombëtare.

Përmes profesionalizmit të tyre, ata kanë ndërtuar një imazh pozitiv për Shqipërinë.



SHQIPËRIA DHE SFIDAT E REJA TË SIGURISË

Bota po përballlet me sfida të reja, luftë hibride, kërcënime kibernetike, terrorizëm ndërkombëtar, destabilizim rajonal, luftë informative dhe dezinformim.

Në këtë realitet të ri, vendet aleate kanë nevojë për partnerë të besueshëm dhe të përgatitur.

Shqipëria po konsolidon rolin e saj si faktor stabiliteti në Ballkanin Perëndimor.

Investimet në modernizimin e Forcave të Armatosura, baza ajrore e NATO-s në Kuçovë, bashkëpunimi strategjik me SHBA-në dhe rritja e kapaciteteve operacionale janë pjesë e këtij vizioni.

Deklaratat si ajo e Eric Wendt konfirmojnë se ky transformim po vlerësohet në nivelet më të larta politike dhe ushtarake amerikane.

USHTARAKU SHQIPTAR, FIGURË E RESPEKTUAR

Ushtaraku shqiptar i sotëm është shumë larg stereotipave të së kaluarës.

Ai është: profesionist, i trajnuar sipas standardeve

moderne, i aftë për interoperabilitet me aleatët, i respektuar në misionet ndërkombëtare.

Por mbi të gjitha, ai mbetet bartës i një tradite të lashtë shqiptare, dashurisë për atdheun dhe ndjenjës së detyrës.

Kjo është arsyeja pse emri i Skënderbeut vazhdon të jetojë në identitetin moral të Forcave tona të Armatosura.

NJË VLERËSIM QË DUHET LEXUAR ME KRENARI

Deklarata e Eric Wendt duhet lexuar si më shumë sesa një frazë diplomatike.

Ajo është: njohje për sakrificën e ushtarakëve shqiptarë, respekt për historinë tonë kombëtare, vlerësim për partneritetin strategjik Shqipëri-SHBA, besim për të ardhmen e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Në një kohë kur bota përballlet me pasiguri të shumta, Shqipëria po dëshmon se mbetet një aleat serioz, një partner i besueshëm dhe një vend që vazhdon të mbajë gjallë frymën e qëndresës dhe dinjitetit kombëtar. Sepse, siç duket, edhe në sytë e aleatëve tanë strategjikë, shpirti i Skënderbeut vazhdon të jetojë te ushtaraku shqiptar.

INTERVISTË ME DREJTORIN E MUZEUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA, STUDIUES DHE KOLEKSIONIST I TRASHËGIMISË HISTORIKE SHQIPTARE, Z. NIKO KOTHERJA

“HISTORIA NUK DUHET TË HESHTË NË ARKIVA, POR TË JETOJË NË KUJTESËN E KOMBIT”



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI, Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një kohë kur ritmi i shpejtë i zhvillimeve globale dhe teknologjia moderne shpesh e largojnë shoqërinë nga reflektimi mbi të kaluarën, muzetë mbeten ndër institucionet më të rëndësishme të kujtesës kombëtare. Ato janë ura që lidhin brezat me historinë, sakrificat, kulturën dhe identitetin e një populli. Pikërisht për këtë arsye, çdo vit, më 18 maj, Dita Ndërkombëtare e Muzeve, e organizuar nga ICOM (Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve) që prej vitit 1977, shërben si një moment reflektimi mbi rolin që muzetë luajnë në edukimin, ruajtjen e trashëgimisë dhe ndërgjegjësimin qytetar.

Në këtë kuadër, Muzeu i Forcave të Armatosura Shqiptare përfaqëson një nga institucionet më të rëndësishme të memories historike dhe ushtarake të vendit. I hapur në dhjetor të vitit 2023, në Bërzhitë të Tiranës, muzeu është konceptuar si një hapësirë moderne muzeale, ku ndërthuren historia, dokumentacioni, teknologjia dhe trashëgimia ushtarake shqiptare ndër shekuj.

Misioni i tij është të identifikojë, të grumbullojë, të ruajë dhe të bëjë të aksesueshme për publikun të gjitha vlerat historike dhe ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht muzeu përmban rreth 3600 objekte muzeale dhe vazhdon të pasurohet me dokumente, armatime, pajisje dhe dëshmi të reja historike.

Në pavijonet e tij, vizitorët mund të ndjekin një udhëtim të plotë në historinë ushtarake shqiptare, duke nisur nga periudha ilire, e Arbrit dhe epoka e Skënderbeut, për të vijuar

me Pashallëqet shqiptare, Pavarësinë, Monarkinë, Luftën Nacionalçlirimtare, Luftën e Ftohtë dhe periudhën komuniste, deri tek Shqipëria anëtare e NATO-s dhe Forcat tona të Armatosura moderne.

Një interes të veçantë zgjon periudha e Luftës së Ftohtë dhe militarizimi ekstrem i Shqipërisë komuniste. Armatimet sovjetike dhe kineze, dokumentet ushtarake, bunkerizimi masiv i vendit dhe organizimi i ushtrisë popullore shqiptare paraqiten përmes objekteve autentike që dëshmojnë një nga

periudhat më të pazakonta të historisë moderne shqiptare. Shqipëria e asaj kohe numëronte mbi 173 mijë bunkerë dhe një ndër nivelet më të larta të militarizimit në rajon.

Përveç pavijoneve të brendshme, muzeu përfshin edhe një ekspozitë në natyrë ku ekspozohen mjete të rënda luftarake, tanke, artileri, mjete ajrore dhe detare, duke krijuar një panoramë të plotë të zhvillimit të ushtrisë shqiptare ndër vite.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, gazeta “Ushtria” zhvilloi këtë intervistë me z. Niko Kotherja, studiues i historisë, koleksionist i njohur dhe Drejtor i Muzeut të Forcave të Armatosura. Në këtë bisedë ai ndalet tek rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë ushtarake shqiptare, sfidat e studimit dhe konservimit të historisë, roli edukues i muzeve dhe nevoja që historia të mos mbetet vetëm në arkiva, por të jetojë në kujtesën e shoqërisë dhe të brezave që vijnë.

Ruajtja e Kujtesës Ushtarake është Ruajtje e Identitetit Kombëtar


Z. Drejtor, në këndvështrimin tuaj si studiues i historisë ushtarake, sa e rëndësishme është historia ushtarake në ndërtimin e identitetit kombëtar shqiptar?

Historia ushtarake është një nga shtyllat kryesore mbi të cilat është ndërtuar identiteti kombëtar shqiptar. Nëse analizojmë historinë e popullit tonë ndër shekuj, do të kuptojmë se mbijetesa e shqiptarëve si komb ka qenë e lidhur ngushtë me aftësinë për të rezistuar, për t’u organizuar dhe për të mbrojtur territorin, kulturën dhe identitetin e tyre.

Që nga periudha ilire, shqiptarët janë përballur vazhdimisht me sfida politike, ushtarake dhe ekzistenciale. Qëndresa e ilirëve ndaj fuqive të mëdha të kohës, organizimi ushtarak i principatave arbërore, epopeja e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, luftërat për pavarësi, rezistenca gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas transformimi i ushtrisë shqiptare në periudhën moderne, janë pjesë e një historie që ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin e ndërgjegjes kombëtare.

Historia ushtarake nuk është thjesht histori luftërash apo armësh. Ajo është histori sakrifice, përgjegjësie dhe mbijetese kolektive. Përmes saj kuptojmë mënyrën si është formuar shteti shqiptar, si janë mbrojtur kufijtë dhe si janë ruajtur vlerat kombëtare në periudha shumë të vështira historike.

Për këtë arsye, njohja e historisë ushtarake është shumë





e rëndësishme, sidomos për brezin e ri. Një shoqëri që nuk njih historinë e vet dhe sakrificat e brezave të mëparshëm rrezikon të humbasë lidhjen me identitetin, me kujtesën dhe me përgjegjësinë qytetare ndaj vendit të saj.

Sa e rëndësishme është ruajtja e trashëgimisë ushtarake dhe çfarë përfaqëson Muzeu i Forcave të Armatosura në këtë drejtim?

Ruajtja e trashëgimisë ushtarake është një detyrim kombëtar dhe institucional. Trashëgimia ushtarake nuk është vetëm një koleksion objektesh të së kaluarës; ajo është dëshmi konkrete e historisë së një kombi. Çdo dokument, uniformë, armë, fotografi apo mjet ushtarak mbart një histori njerëzore dhe historike që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e shtetit shqiptar dhe të Forcave të Armatosura.

Muzeu i Forcave të Armatosura ka pikërisht këtë mision, identifikimin, grumbullimin, restaurimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë ushtarake shqiptare. Ai është një institucion kujtese dhe edukimi që synon ta sjellë historinë më pranë qytetarëve dhe brezave të rinj.

Muzeu, i hapur në dhjetor 2023, në Bërzhitë të Tiranës, përfaqëson një nga projektet muzeale më moderne dhe më të rëndësishme në Shqipëri. Aktualisht muzeu ruan rreth 3600 objekte muzeale dhe fondi vazhdon të pasurohet vazhdimisht me materiale të reja me vlerë historike.

Në muze janë të përfaqësuara pothuajse të gjitha periudhat e historisë ushtarake shqiptare: periudha ilire, Arbri mesjetar, epoka e Skënderbeut, Pashallëqet shqiptare, periudha e Pavarësisë, Monarkia, Lufta Nacionalçlirimtare, Lufta e Ftohtë, sistemi komunist dhe Shqipëria në NATO.



Qëllimi ynë nuk është vetëm ekspozimi i objekteve, por krijimi i një hapësire ku historia të kuptohet, të studiohet dhe të përjetohet. Ne synojmë që muzeu të jetë një urë lidhëse mes historisë dhe brezave të rinj.

Cilat periudha historike ju kanë tërhequr më shumë gjatë punës suaj kërkimore?

Çdo periudhë historike ka rëndësinë dhe kompleksitetin e saj, por disa prej tyre kanë qenë veçanërisht interesante për mua si studiues.

Epoka e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut mbetet padyshim një nga periudhat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare dhe ushtarake. Ajo përfaqëson jo vetëm rezistencën shqiptare ndaj Perandorisë Osmane, por edhe organizimin politik dhe ushtarak të shqiptarëve në një periudhë shumë të vështirë historike. Skënderbeu arriti të krijojë një model rezistence që vazhdon të mbetet simbol i identitetit dhe krenarisë kombëtare.

Një tjetër periudhë që më ka tërhequr shumë është ajo e Luftës së Ftohtë dhe militarizimit të Shqipërisë komuniste. Shqipëria ishte një rast unik në Europë për shkallën e bunkerizimit dhe të organizimit mbrojtës. Frika e një pushtimi të jashtëm çoi në krijimin e një sistemi të jashtëzakonshëm fortifikimesh dhe të një ushtrie masive për përmasat e vendit. Në vitet '70-'80 ushtria shqiptare kishte rreth 61 mijë forca



aktive dhe mbi 260 mijë rezervistë. Në territorin e vendit ishin ngritur mbi 173 mijë bunkerë të tipave të ndryshëm dhe rreth 2200 pika mbrojtëse. Kjo e bën Shqipërinë një rast shumë interesant studimi për historianët ushtarakë dhe studiuesit e Luftës së Ftohtë.

Kjo periudhë nuk duhet parë vetëm nga aspekti ushtarak, por edhe si fenomen social, ekonomik dhe psikologjik që ndikoi thellësisht në jetën e shqiptarëve.

Sa e ruajtur dhe sa e dokumentuar mendoni se është sot trashëgimia ushtarake shqiptare?

Trashëgimia ushtarake shqiptare është jashtëzakonisht e pasur dhe shumëdimensionale. Shqipëria ka kaluar nëpër periudha të ndryshme historike dhe politike, duke krijuar një fond të madh dokumentesh, objektesh, uniformash, armatimesh dhe materialesh arkivore.

Fatkeqësisht, për shumë vite kjo trashëgimi nuk ka marrë vëmendjen e duhur. Ka pasur mungesë investimesh, mungesë hapësirash muzeale dhe shpesh mungesë ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së saj. Si pasojë, shumë objekte me vlerë historike janë dëmtuar ose humbur.

Megjithatë, vitet e fundit situata po ndryshon. Ka një interes gjithnjë e më të madh nga publiku, veçanërisht nga të rinjtë, për të njohur historinë reale të ushtrisë shqiptare dhe zhvillimet e saj ndër vite.

Ne po punojmë që kjo trashëgimi të mos mbetet vetëm në depo apo arkiva, por të bëhet pjesë aktive e edukimit historik dhe kulturor të shoqërisë.

Cilat janë objektet dhe koleksionet më të rëndësishme që ruhen aktualisht në muze?

Muzeu ka një fond shumë të pasur objektesh muzeale

dhe dokumentare. Vizitorët mund të shohin armë historike të periudhave të ndryshme, uniforma ushtarake shqiptare dhe të huaja, dokumente origjinale, pajisje komunikimi, medalje, flamuj, harta ushtarake dhe mjete të ndryshme luftarake.

Një interes të madh zgjon pavijoni i Luftës së Ftohtë dhe periudhës komuniste, ku ekspozohen armë sovjetike, kineze dhe pajisje të ushtrisë popullore shqiptare. Kjo periudhë përfaqëson kulmin e militarizimit të Shqipërisë.

Gjithashtu shumë të rëndësishme janë ekspozitat në natyrë ku ndodhen tanke, artileri, mjete të blinduara, avionë, automjete ushtarake dhe mjete detare.

Por përtej mjeteve luftarake, një vlerë shumë të madhe kanë dokumentet historike, ditarët personalë, korrespondencat ushtarake dhe fotografitë origjinale. Ato e bëjnë historinë më njerëzore dhe më të prekshme.

Cili ka qenë objekti apo dokumenti që ju ka impresionuar më shumë?

Ka shumë objekte që të emocionojnë, sepse secili prej tyre mbart një histori njerëzore. Personalisht më kanë bërë shumë përshtypje dokumentet origjinale të luftërave dhe korrespondencat personale të ushtarakëve.

Kur lexon një letër të shkruar nga një ushtar në front apo sheh një uniformë të përdorur në një moment historik, historia nuk mbetet më abstrakte. Ajo bëhet reale dhe njerëzore.

Këto objekte të japin ndjesinë sikur po komunikon drejtpërdrejt me të kaluarën. Ato të bëjnë të kuptosh se pas çdo dokumenti, pas çdo fotografie apo arme, fshihet jeta e një njeriu, një familjeje dhe një kohe të tërë historike.

Sa e vështirë është sot puna për identifikimin dhe restaurimin e objekteve historike ushtarake?

Është një proces shumë kompleks dhe i lodhshëm. Shumë objekte kanë kaluar dekada të tëra në kushte jo të përshtatshme ruajtjeje dhe janë dëmtuar nga lagështira, koha apo mungesa e konservimit profesional.

Restaurimi kërkon specialistë të trajnuar, laboratorë, teknologji dhe financime. Ndërsa identifikimi i objekteve shpesh kërkon një punë të gjatë kërkimore dhe krahasim me dokumente arkivore apo materiale ndërkombëtare.

Megjithatë, sot ka më shumë ndërgjegjësim institucional dhe publik për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë historike dhe kjo është shumë pozitive.

Sa ndihmon teknologjia në ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e objekteve muzeale?

Teknologjia sot është një domosdoshmëri për çdo muze modern. Brezi i ri komunikon ndryshe me informacionin dhe institucionet muzeale duhet të përshtaten me këtë realitet.

Në Muzeun e Forcave të Armatosura përdoren teknika moderne ekspozimi, ndriçimi, skenografie dhe konservimi për ta bërë eksperiencën sa më interaktive dhe edukative.

Synimi ynë është që vizitori të mos shohë vetëm objekte, por të përjetojë historinë përmes teknologjisë, materialeve multimediale dhe narrativës muzeale.

Në të ardhmen synojmë të zgjerojmë arkivat digjitale, projektet online dhe përdorimin e teknologjive interaktive për ta bërë muzeun më të aksesueshëm për publikun shqiptar dhe të huaj.



Si e shihni rolin e muzeve ushtarakë në edukimin patriotik dhe qytetar të shoqërisë?

Muzetë ushtarakë janë institucione të kujtesës dhe edukimit qytetar. Patriotizmi nuk ndërtohet me slogane apo retorikë, por me njohje të historisë dhe respekt për sakrificat e brezave të mëparshëm. Kur një i ri sheh nga afër një dokument autentik, një uniformë historike apo një objekt real të historisë ushtarake shqiptare, krijojnë një lidhje më të fortë emocionale dhe qytetare me vendin e tij.

Muzetë ndihmojnë në formimin e ndërgjegjes historike dhe në kuptimin e vlerës së paqes, sigurisë dhe shtetit.

Cili është mesazhi juaj për brezin e ri?

Brezi i ri duhet të kuptojë se historia nuk është vetëm e kaluar, ajo është pjesë e identitetit dhe e së ardhmes sonë.

I ftoj të rinjtë të lexojnë, të studiojnë, të vizitojnë muzetë dhe të ruajnë kujtesën kombëtare. Një popull që njih historinë e vet është më i fortë, më i vetëdijshëm dhe më i përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Muzeu i Forcave të Armatosura është një hapësirë ku historia e ushtrisë shqiptare bëhet e prekshme për çdo qytetar. Ruajtja e kësaj trashëgimie është përgjegjësi e përbashkët dhe një detyrë ndaj brezave që do të vijnë.

SHOQËRIA QË NUK PRANON TRANSFORMIMIN E NJERIUT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në çdo epokë, njeriu ka kaluar përmes proceseve të thella transformimi. Luftërat, sfidat personale, përgjegjësitë, humbjet, idealet dhe koha kanë ndryshuar mënyrën se si ai mendon, ndien dhe jeton. Megjithatë, paradoksi më i madh i shoqërisë moderne mbetet fakti se, ndërsa jeta kërkon vazhdimisht ndryshim, vetë shoqëria shpesh refuzon ta pranojë atë tek individi.

Njerëzit kanë tendencën të mbajnë mend imazhin që kanë krijuar dikur për dikë dhe ta përdorin atë si standard të përhershëm gjykimi. Një individ që ka kaluar një periudhë të vështirë vazhdon të shihet përmes gabimeve të së kaluarës; një njeri që ka qenë dikur i heshtur trajtohet sikur të mos ketë fituar kurrë zë; dikush që ka ndryshuar mënyrën e të menduarit shpesh konsiderohet si i larguar nga vetvetja, ndërkohë që në realitet mund të jetë më pranë vetes se kurrë më parë.

Kjo mënyrë e të gjykuarit nuk është vetëm padrejtësi individuale. Është një problem i thellë shoqëror që pengon zhvillimin njerëzor dhe dobëson marrëdhëniet mes individëve. Sepse çdo njeri ka të drejtë të evoluojë. Çdo njeri ka të drejtë të mos mbetet peng i versionit të tij të dikurshëm.

Në jetën e përditshme, shpesh ndeshim individë që kanë ndryshuar rrënjësisht pas përvojave të forta jetësore. Ka të rinj që janë pjekur përmes vështirësive ekonomike, ushtarakë që janë kthyer ndryshe nga misionet, prindër që janë transformuar nga përgjegjësia, njerëz që pas humbjeve kanë fituar një qetësi të re dhe të tjerë që kanë ndërtuar forcë pikërisht aty ku dikur kishin dobësi. Por jo gjithmonë këto ndryshime kuptohen apo pranohen nga të tjerët.

Shoqëria shpesh sillet sikur njeriu duhet të mbetet i pandryshueshëm, sikur karakteri, mendimet dhe emocionet të jenë të ngrira në kohë. Në realitet, njeriu është qenie dinamike. Ai ndërtohet dhe rindërtohet vazhdimisht. Çdo përvojë lë gjurmë. Çdo sfidë krijon një dimension të ri të personalitetit. Dhe pikërisht kjo aftësi për t'u transformuar është një nga dëshmitë më të mëdha të forcës njerëzore.

Në një kohë kur bota po ndryshon me ritme të shpejta, edhe individi ndryshon me të. Teknologjia, ritmi i jetës, presioni social, pasiguria ekonomike dhe zhvillimet globale kanë krijuar një realitet ku njerëzit janë të detyruar të përshtaten vazhdimisht. Megjithatë, ndërsa kërkohet fleksibilitet profesional dhe intelektual, shpesh mungon fleksibiliteti emocional dhe njerëzor për të pranuar ndryshimin e atyre që kemi pranë.

Një nga problemet më të mëdha të marrëdhënieve njerëzore sot është paragjykimi i ngrirë. Njerëzit nuk komunikojnë gjithmonë me atë që je sot, por me kujtimin që kanë krijuar për ty vite më parë. Kjo sjell keqkuptime, distancë dhe shpesh padrejtësi morale. Individi ndihet i detyruar të mbrojë vazhdimisht identitetin e tij të ri përballë atyre që refuzojnë ta shohin ndryshe.

Kjo dukuri vihet re edhe në institucionet shoqërore. Në shumë raste, sistemet tona vazhdojnë ta trajtojnë individin mbi bazën e perceptimeve të vjetra dhe jo mbi realitetin aktual. Një person që ka reflektuar dhe është përmirësuar mund të



vazhdojë të përballët me mosbesim. Një profesionist që ka fituar eksperiencë të re shpesh paragjykohet nga pozicioni që ka pasur dikur. Një qytetar që kërkon një mundësi të dytë jo rrallë mbetet peng i etiketave të së kaluarës.

Kjo qasje është e rrezikshme për një shoqëri që synon progres. Sepse progresi nuk ndërtohet vetëm me teknologji apo zhvillim ekonomik, ai ndërtohet mbi aftësinë për të kuptuar njeriun dhe potencialin e tij për ndryshim.

Në këtë aspekt, një rëndësi të veçantë ka mënyra se si i edukojmë brezat e rinj. Nëse fëmijët dhe të rinjtë rriten në një kulturë ku gabimi konsiderohet vulë e përhershme dhe jo mundësi reflektimi, atëherë krijojmë individë që kanë frikë të provojnë, të ndryshojnë apo të përmirësohen.

Shoqëria duhet të edukojë idenë se njeriu nuk përcaktohet vetëm nga e kaluara, por edhe nga aftësia për të ndërtuar të ardhmen.

Në të kundërt, kur ndryshimi pranohet dhe mbështetet, individi fiton besim për të ecur përpara. Ai nuk jeton më nën peshën e vazhdueshme të gjykimit, por krijon mundësi për zhvillim personal dhe profesional. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për brezin e ri, i cili përballët me sfida të shumta identitare në një botë të mbushur me presion social dhe standarde artificiale.

Sot shumë njerëz ndihen të vetmuar jo sepse nuk kanë të tjerë pranë, por sepse nuk ndihen të kuptuar në transformimin e tyre. Ata ndihen të detyruar të shpjegojnë vazhdimisht pse kanë ndryshuar, pse nuk reagojnë më si dikur, pse kanë zgjedhur një rrugë tjetër apo pse nuk i përkasin më të njëjtës mënyrë jetese. Kjo lodhje emocionale krijon distancë dhe shpesh çon në izolim shpirtëror.

Në fakt, një nga shenjat më të qarta të pjekurisë njerëzore është aftësia për ta parë tjetrin si proces dhe jo si produkt të përfunduar. Njeriu nuk është statujë. Ai nuk mbetet i njëjtë pas sfidave të jetës. Përvoja e ndryshon. Koha e ndryshon.

Përgjegjësia e ndryshon. Dhe kjo duhet kuptuar si pjesë natyrore e ekzistencës.

Në jetën institucionale dhe ushtarake kjo merr një kuptim edhe më të thellë. Ushtaraku, për shembull, formohet vazhdimisht nga disiplina, sakrifica, përgjegjësia dhe përballja me situata që shumica e njerëzve nuk i përjetojnë kurrë. Ai nuk mbetet i njëjti pas çdo misioni, pas çdo prove apo pas çdo detyre të vështirë. Përvoja krijon një njeri më të fortë, më të përmbajtur dhe më të vetëdijshëm për realitetin e jetës. Dhe pikërisht kjo aftësi për t'u transformuar është pjesë e karakterit të tij profesional dhe njerëzor.

Shoqëria duhet të mësojë të respektojë këtë proces. Duhet të kuptojë se ndryshimi nuk është dobësi, por dëshmi e jetës së përjetuar. Njeriu që ndryshon nuk po tradhton vetveten, ai po ndërton një version më të pjekur të saj.

Nëse vazhdojmë t'i shohim njerëzit vetëm përmes së kaluarës, rrezikojmë të humbim mundësinë për të njohur potencialin e tyre të vërtetë. Rrezikojmë të mbetemi peng të paragjykimeve dhe të krijojmë një kulturë ku individi ndihet i detyruar të mos ndryshojë vetëm për të mos u gjykuar.

Por jeta vetë është transformim. Asgjë nuk mbetet e pandryshueshme. Brezat ndryshojnë, shoqëritë evoluojnë, mendësitë zhvillohen dhe bashkë me to duhet të ndryshojë edhe mënyra si e shohim njëri-tjetrin.

Një shoqëri e fortë është ajo që i jep individit mundësinë të rilindë pa u dënuar përjetësisht nga e kaluara. Është ajo që kupton se njeriu nuk duhet matur me kujtimet e dikurshme, por me karakterin që ndërton çdo ditë.

Sepse në fund, madhështia e njeriut nuk qëndron tek fakti që mbetet gjithmonë i njëjtë. Madhështia qëndron tek aftësia për të ndryshuar, për të reflektuar, për t'u ngritur pas rënies dhe për të vazhduar përpara si një version më i fortë, më i vetëdijshëm dhe më njerëzor i vetvetes.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kur mungesa e kulturës individuale dëmton figurën e shtetit

Institucionet shtetërore janë pasqyra morale dhe qytetare e një shteti. Qytetari krijon perceptimin për shtetin jo nga fjalimet politike, as nga sloganet apo fasadat institucionale, por nga sjellja konkrete e individëve që takon çdo ditë në sportele, zyra, administratë dhe ambiente publike.

Pikërisht këtu shfaqet një nga problemet më shqetësuese të realitetit tonë institucional, mungesa e edukatës personale, kultura e dobët e komunikimit dhe degradimi i etikës individuale tek një pjesë e njerëzve që ushtrojnë funksione publike.

Në shumë raste, qytetari nuk përballlet me profesionalizëm, mirëkuptim dhe korrektësi, por me arrogancë, nervozizëm, mungesë respekti dhe sjellje denigruese. Kjo nuk është vetëm çështje karakteri individual. Është problem serioz institucional dhe shoqëror, sepse çdo punonjësi i administratës përfaqëson shtetin.

Një fjalë e rëndë, një ton përçmues, një sjellje arrogante apo një mungesë minimale edukate nuk dëmton vetëm marrëdhënien mes dy individëve.

Ajo godet besimin e qytetarit të institucioni dhe krijon ndjenjën se shteti është larg qytetarit, i ftohtë dhe pa ndjeshmëri njerëzore.

**MUNGESA E KULTURËS PERSONALE
NUK MBULOHEK ME TITULL APO DETYRË**

Një nga problemet më të dukshme të kohës sonë është fakti se shumë individë ngatërrojnë pozitën me kulturën dhe autoritetin me arrogancën.

Detyra shtetërore nuk e bën automatikisht njeriun të edukuar, profesional apo qytetar. Pozita administrative nuk zëvendëson kulturën personale.

Në shumë institucione shohim individë që: nuk dinë të komunikojnë me etikë,

nuk respektojnë qytetarin, nuk kontrollojnë tonin e komunikimit,

tregojnë mungesë durimi dhe edukate bazike, e konsiderojnë qytetarin si barrë dhe jo si detyrim institucional.

Në realitet, problemi nuk fillon te mungesa e ligjeve apo rregulloreve. Problemi fillon te mungesa e formimit personal dhe qytetar. Sepse edukata nuk është procedurë administrative. Ajo është kulturë njerëzore.

**KUR SJELLJA E NJË PUNONJËSI
DËMTON FIGURËN E INSTITUCIONIT**

Qytetari nuk e ndan institucionin nga individi që e përfaqëson atë. Kur një punonjësi sillet me arrogancë, indiferencë apo mungesë respekti, qytetari nuk thotë: “Ky individ ishte i pasjellshëm”. Ai thotë: “Ky institucion nuk funksionon”. Kjo është arsyeja pse kultura personale e çdo punonjësi publik ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Një administratë mund të ketë, zyra moderne, teknologji, rregullore, struktura organizative, por nëse mungon edukata njerëzore, gjithçka humbet vlerë.

ARROGANCA SI KEQKUPITIM I AUTORITETIT

Një fenomen tjetër shqetësues është perceptimi i gabuar i autoritetit. Disa individë, sapo marrin një funksion administrativ apo institucional, fillojnë të krijojnë distancë artificiale me qytetarin apo “vartësin”. Sillen me mendjemadhësi dhe krijojnë ndjesinë sikur pozita i vendos mbi të tjerët.

Në të vërtetë, autoriteti institucional nuk matet me ashpërsi apo arrogancë. Ai matet me profesionalizëm, qetësi dhe dinjitet.

Njeriu i edukuar: nuk bërtet, nuk fyen, nuk nënçmon, nuk sillet me nervozizëm, nuk e përdor pozitën për të imponuar frikë. Përkundrazi, ai imponon respekt përmes kulturës dhe korrektësisë. Fatkeqësisht, në disa ambiente institucionale është krijuar ideja se sjellja arrogante përfaqëson forcë apo “autoritet”. Në realitet ajo është shenjë e mungesës së formimit personal.

ETIKA FILLON NGA SJELLJA E THJESHTË

Etika institucionale nuk fillon te dokumentet zyrtare. Ajo fillon te mënyra si i drejtohesh një qytetari.

Një “Mirëmëngjes”, një ton normal komunikimi, një përgjigje korrekte apo një sqarim njerëzor kanë ndikim të

KRIZA E EDUKATËS DHE SJELLJES PERSONALE NË INSTITUCIONET SHTETËRORE



madh në perceptimin publik. Shpesh qytetarët nuk kërkojnë privilegje. Ata kërkojnë vetëm respekt, komunikim normal, korrektësi, trajtim njerëzor.

Kur përballen vazhdimisht me nervozizëm dhe mungesë kulture, krijohet lodhje psikologjike dhe mosbesim ndaj institucioneve.

Është shqetësuese kur individë që kanë detyrë publike nuk kuptojnë se sjellja e tyre nuk është private. Ajo është pjesë e imazhit institucional të shtetit.

**PROBLEMI I EDUKATËS NUK ZGJIDHET
VETËM ME DIPLOMA**

Një tjetër realitet që duhet pranuar është se diploma nuk garanton kulturë qytetare.

Mund të kesh arsimim të lartë dhe njëkohësisht, mungesë etike, mungesë qytetarie, mungesë komunikimi njerëzor, mungesë vetëkontrolli.

Institucionet shpesh fokusohen vetëm te aspekti teknik i punës, por harrojnë dimensionin njerëzor të administratës.

Një profesionist i mirë nuk është vetëm ai që njih procedurat. Është ai që di të sillet me dinjitet dhe respekt.

Sepse administrata publike nuk është thjesht mekanizëm dokumentesh. Ajo është marrëdhënie njerëzore.

PASOJAT E KËSAJ KLIME

Kur mungesa e edukatës bëhet normale në institucione, pasojat janë të rënda, qytetarët humbin besimin, krijohet urrejtje ndaj administratës, shtohet tensioni social, bie autoriteti institucional, krijohet ndarje mes shtetit dhe qytetarit.

Në shumë raste, sjellja jo etike e një individi njollos punën e qindra profesionistëve korrektë që punojnë me përkushtim. Sepse mjafton një eksperiencë negative që qytetari të krijojë perceptim negativ për gjithë institucionin.

**KULTURA INSTITUCIONALE NIS NGA KULTURA
PERSONALE**

Nuk mund të ketë administratë të shëndetshme pa individë me kulturë njerëzore dhe etikë personale.

Shteti nuk ndërtohet vetëm me ligje e vendime. Ai ndërtohet me sjellje, përgjegjësi dhe qytetari.

Prandaj është e domosdoshme që institucionet të forcojnë standardet etike, të kërkohet më shumë kulturë komunikimi, të trajnohen punonjësit për etikën publike, të mos tolerohen sjelljet denigruese, të vlerësohen individët korrektë dhe profesionalë.

KUR EDUKATA BËHET “LUKS”

Është shqetësuese të shohësh se si disa njerëz, sapo marrin një detyrë apo një post administrativ, harrojnë elementët bazë të komunikimit.

Një “Mirëmëngjes” nuk kushton asgjë. Një buzëqeshje nuk ul autoritetin e askujt. Një “Mirupafshim” nuk e zvogëlon pozitën e askujt.

Përkundrazi, ato tregojnë qytetari. Por sot duket sikur në disa institucione edukata po konsiderohet dobësi, ndërsa arroganca po ngatërrohet me seriozitetin.

Ka punonjës që: nuk përshëndesin, nuk të shohin në sy, flasin me ton urdhërues, krijojnë distancë artificiale. Dhe kjo është një nga shenjat më të dukshme të degradimit të kulturës personale në administratë.

NJË FJALË E THJESHTË KA PESHË TË MADHE

Në shumë vende të zhvilluara, edukata në komunikim konsiderohet pjesë e profesionalizmit.

Një “Tungjatjeta” e thënë me korrektësi krijon afërsi njerëzore. Një “Mirë se erdhët” krijon respekt. Një “Mirupafshim” tregon kulturë. Por kur këto mungojnë, krijohet ndjesia e ftohtësisë institucionale.

**ADMINISTRATA NUK ËSHTË
VETËM PROCEDURË**

Një pjesë e njerëzve në institucione duket sikur harrojnë se puna e tyre lidhet drejtpërdrejt me njerëzit. Institucioni nuk është vetëm: vulë, dokument, firmë, procedurë. Institucioni është komunikim njerëzor.

‘Mirëmëngjes’, ‘Tungjatjeta’ apo ‘Mirupafshim’ janë fjalë të vogla, por me vlerë të madhe njerëzore.

Institucionet nuk bëhen dinjitoze vetëm nga muret apo titujt, por nga kultura, respekti dhe mirësjellja e njerëzve që i përfaqësojnë ato. Sepse qytetaria fillon aty ku njeriu respekton njeriun.

LEGJENDA E DRENICËS: Shotë Galica dhe lufta për Kosovën

Nga vajza e Drenicës në komandanten e çetave kryengritëse shqiptare

Historia kombëtare shqiptare njihet shumë figura të mëdha që me jetën dhe veprën e tyre u shndërruan në simbole të lirisë, trimërisë dhe sakrificës. Por ndër emrat më të ndritur të rezistencës shqiptare në Kosovë, vend të veçantë zë Shote Galica, gruaja që sfidoi pushtuesit, zakonet patriarkale dhe vështirësitë e kohës për t'u bërë një nga komandantet më të njohura të luftës shqiptare për liri.

Jeta e saj ishte një histori sakrifice, qëndrese dhe heroizmi. Për 12 vjet me radhë ajo jetoi në male me pushkë në dorë, luftoi përkrah burrave më të njohur të Kosovës dhe mbeti deri në fund simbol i gruas shqiptare që nuk iu nënshtrua as armikut dhe as paragjytimeve.

FËMIJËRIA DHE RITJA NË DRENICË

Shote Galica lindi në vjeshtë të vitit 1895 në Radishevë të Drenicës, në familjen patriotike të Halil Radishevës. Ishte motra e vetme mes gjashtë vëllezërve dhe lindja e saj u prit me gëzim të madh. Edhe pse në atë kohë nuk ishte zakon të qëllohej me armë kur lindte vajzë, familja e saj e festoi ardhjen në jetë të Qerimes me të shtëna pushkësh.

Më vonë ajo do të njihej me emrin “Shota”, emër që ia kishte vendosur i ati me përkëdheli. Në Kosovë, “shotë” quhej rosa e vogël dhe e bukur, ndërsa ky emër përdorej shpesh për vajzat shtatshkurtra e topolake. Askush nuk mund ta imagjinonte se ky emër do të bëhej një simbol i pavdekshëm i rezistencës shqiptare.

Familja e saj ishte e njohur për tradita patriotike. I ati, Halili, merrte pjesë në kuvendet e burrave të Drenicës dhe vajza e vogël shpesh qëndronte pranë tij duke dëgjuar rrëfimet për luftërat e shqiptarëve kundër pushtuesve.

Në atë kohë në Drenicë nuk kishte shkollë shqipe. Arsimi i vërtetë zhvillohej në oda. Oda shqiptare ishte institucioni ku ruhej kujtesa historike e kombit. Aty tregoheshin historitë e trimërisë, këndoheshin këngët e luftës dhe edukoheshin brezat me ndjenjën e dashurisë për atdheun.



Shota dëgjonte me admirim rrëfimet për Lidhjen e Prizrenit, për luftërat në Nish, Vranjë, Kaçanik, Plavë e Guci dhe për sakrificat e burrave të Drenicës. Këto histori i rrënjosën thellë në zemër ndjenjën e lirisë dhe urrejtjen ndaj pushtuesve.

DRENICA NË FLAKËT E LUFTËS

Radisheva, vendlindja e Shotës, ishte një nga fshatrat më të goditur nga luftërat. Vetëm gjatë viteve 1909-1919 ajo u dogj tri herë: një herë nga ushtria osmane dhe dy herë nga pushtuesit serbo-malazezë.

Shota i përjetoi vetë këto tragjedi. Ajo pa me sytë e saj djegien e shtëpive shqiptare, vrasjet dhe urinë që përfshiu Drenicën. Gjatë verës së vitit 1909, familjet shqiptare detyroheshin të kërkonin ushqim nëpër ara dhe pyje për të mbijetuar.

Këto vuajtje forcuan karakterin e saj dhe e përgatitën për jetën e vështirë që do ta priste më vonë në male.

KRYENGRITJA E VITIT 1912 DHE NJOHJA ME AZEM GALICËN

Viti 1912 ishte një nga momentet më të rëndësishme të historisë shqiptare. Kryengritja Shqiptare e vitit 1912 shpërtheu në Kosovë dhe Drenica u bë një nga qendrat kryesore të saj.

Në këtë kohë emri i Azem Galicës kishte filluar të bëhej legjendar. I ri në moshë, por i njohur për trimëri të jashtëzakonshme, Azemi ishte kthyer në simbol të qëndresës kundër pushtuesve serbë.

Shota e admironte atë dhe kishte vendosur që jetën ta lidhte vetëm me Azemin. Edhe pse ai ndodhej në burgjet serbe, ajo e priti me besnikëri.

Në pranverën e vitit 1915, Azemi u arratis nga burgu serb pas një arratisjeje spektakolare. Pas një udhëtimi të gjatë e të rrezikshëm ai arriti në Drenicë dhe rifilloi menjëherë luftën.

Pak kohë më vonë u realizua edhe martesë e tyre.

DASMA E LUFTËTARËVE

Dasma e Azem Galicës dhe Shote Galicës ishte krejt e pazakontë. Azemi ishte në kërkim nga pushtuesit dhe jetonte në male. Për këtë arsye dasma u zhvillua mes luftëtarëve të çetave kryengritëse. Kur shokët e uruan Azemin duke i thënë: “Ke marrë nuse të mirë”, ai u përgjigj: “Jo nuse për

shtëpi, por nuse për në mal”. Fjalët e tij rezultuan profetike.

Vetëm dy javë pas martesës, Shota mori pushkën dhe doli maleve përkrah të shoqit.

NUSJA QË SFIDOI KANUNIN

Dalja e Shotës në mal ishte një akt i jashtëzakonshëm për kohën.

Në shoqërinë shqiptare të asaj periudhe gruaja ishte e kufizuar nga zakone të forta patriarkale. Nuk pranohej të rrinte mes burrave, e aq më pak të luftonte me armë. Por Shota sfidoi gjithçka. Ajo veshi rrobat e luftëtarit, mbajti armë dhe jetoi për 12 vjet mes çetave kryengritëse. Luftoi në beteja, organizoi prita dhe fitoi respektin e burrave të Drenicës. Në fillim shumë njerëz e kritikuan. Disa thoshin se kishte “koritur” familjen.

Por ajo iu përgjigj me trimëri: Kur grueja del maleve për liri, nuk asht marre, por nder e trimni”. Gradualisht ajo fitoi admirimin e të gjithëve. Luftëtarët që dikur nuk pranonin as praninë e grave, filluan ta konsideronin Shotën si njërën prej tyre.

KOMANDANTJA E DRENICËS

Gjatë viteve 1916-1918, Shota dhe Azemi drejtuan luftën kundër forcave austro-hungareze dhe bullgare në Kosovë.

Çetat shqiptare përdornin taktika guerile: lëvizje të shpejta, prita dhe sulme të befasishme kundër postave armike.

Shote Galica u dallua si luftëtare e guximshme dhe organizatore e aftë. Ajo kërkonte disiplinë, respekt për popullin dhe unitet mes shqiptarëve.

Emri i saj u përhap në gjithë Kosovën. Populli filloi t'i këndonte këngë trimërie dhe ta quante “trimnesha e Drenicës”.

Shota nuk ishte më vetëm bashkëshortja e Azemit. Ajo ishte bërë komandante.

LUFTA PËR MBIJETESË DHE HUMBJA E AZEMIT

Lufta e pandërprerë solli edhe sakrifica të mëdha. Shtëpia e Azemit u dogj nga xhandarët serbë. Familjet e tyre jetonin vazhdimisht në arrati. Dimrat në male ishin të egër dhe mungesa e ushqimit ishte e përhershme. Megjithatë, Shota nuk u dorëzua kurrë. Më 17 korrik 1924, Azem Galica ndërroi jetë nga plagët e marra në luftë.

Vdekja e tij ishte një goditje e rëndë për Shotën dhe për gjithë rezistencën shqiptare në Kosovë.

FUNDI TRAGJIK I HEROINËS

Pas vdekjes së Azemit, Shota mbeti e sëmurë, e plagosur dhe në kushte të rënda ekonomike.

Ajo u vendos në Shqipëri, fillimisht në Krujë e më pas në Tiranë. Në një letër drejtuar autoriteteve shqiptare më 1926, ajo shkruante: “Jam tue vdekë nga uria”. Megjithëse kishte sakrifikuar gjithçka për kombin, shteti shqiptar i kohës nuk tregoi kujdesin e duhur për të. Plagët iu rënduan dhe shëndeti iu përkeqësua vazhdimisht. Në fund të korrikut të vitit 1927, në moshën vetëm 32-vjeçare, Shote Galica ndërroi jetë në Derven të Fushë-Krujës.

Para vdekjes la amanet që të varrosej pranë rrugës Shkodër-Tiranë, në mënyrë që çdo shqiptar të kujtonte sakrificën e saj për lirinë e Kosovës.

SHOTË GALICA, SIMBOL I GRUAS SHQIPTARE

Figura e Shotë Galicës mbetet një nga simbolet më të fuqishme të historisë shqiptare. Ajo ishte: luftëtare e lirisë, komandante kryengritëse, simbol i gruas shqiptare, shembull i sakrificës kombëtare.

Shota dëshmoi se gruaja shqiptare mund të ishte jo vetëm nënë dhe bashkëshorte, por edhe luftëtare e pathyeshme për lirinë e kombit.

Ajo jetoi me pushkë në dorë dhe vdiq në varfëri, por emri i saj mbeti i pavdekshëm në historinë shqiptare.

Sot Shotë Galica kujtohet si një ndër heroinat më të mëdha të kombit shqiptar dhe si simbol i qëndresës së Kosovës për liri.



Eduard Demo

Në historinë e gjatë të përpjekjeve të popullit shqiptar për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar, krahas figurave të mëdha që kanë hyrë në tekstet e historisë, qëndrojnë edhe dhjetëra e qindra luftëtarë popullorë, të cilët me pushkë në dorë, me besë e me sakrificë, u bënë shtyllë e qëndresës kombëtare. Një prej tyre ishte edhe Sako Sali Sakaj (1889–1982), biri i Ploçës së Vlorës, luftëtar i vendosur, patriot i heshtur dhe mbrojtës i palodhur i çështjes shqiptare.

Fshati Ploçë, i njohur jo vetëm për praninë madhështore të qytetit antik ilir të Amantias, por edhe për traditën e burrave luftëtarë e patriotë, i dha Shqipërisë figura të shquara të qëndresës kombëtare. Në këtë truall të mbushur me histori dhe krenari kombëtare u formua edhe karakteri i Sako Sakajt. Ai u rrit në një familje dhe mjedis ku fjala “atdhe” kishte peshën e besës dhe ku liria shihej si amanet i të parëve.

Që në rininë e hershme, ai u edukua me ndjenjat patriotike dhe me urrejtjen ndaj pushtuesve. Brezi i tij jetoi në kohë të trazuara, kur Shqipëria përpigjej të dilte nga robëria shekullore osmane dhe të ruante trojet nga copëtimi i fqinjëve. Në këtë atmosferë lufte dhe përpjekjeje kombëtare, u farkëtua edhe personaliteti i tij si luftëtar popullor

Në pritjen historike të Ismail Qemalit

Një nga momentet që do të mbetet i paharruar në jetën e Sako Sakajt ishte pjesëmarrja në pritjen që iu bë patriotit të madh shqiptar Ismail Qemali në vjeshtën e vitit 1908 në stadiumin e Amantias në Ploçë.

Ai ishte ndër të rinjtë që morën pjesë në atë tubim historik, ku fjala e Ismail Qemalit për lirinë, bashkimin dhe të ardhmen e Shqipërisë ndezi zemrat e shqiptarëve. Për Sako Sakajn, ky takim ishte më shumë se një ngjarje politike, ishte një betim moral për t'i shërbyer atdheut deri në fund të jetës.

Në kujtesën popullore të zonës ruhen ende jehonat e asaj dite, kur burrat e Labërisë pritën me nderime plakun e Vlorës dhe dëgjuan mesazhin e tij për një Shqipëri të lirë dhe të pavarur.

Në luftërat për çlirimin e trojeve shqiptare

Me fillimin e kryengritjeve kombëtare, Sako Sakaj u rreshtua në batalionin shqiptar të komanduar nga luftëtari i njohur Kanan Maze. Së bashku me trembëdhjetë bashkëfshatarë nga Ploça, ai mori pjesë në përpjekjet për mbrojtjen e trojeve shqiptare në jug.

Në Luftën e Janinës gjatë viteve 1911–1912, ai u dallua për trimëri dhe aftësi luftarake. Luftimet ishin të ashpra dhe zhvilloheshin në kushte tepër të vështira. Për disa ditë me radhë, luftëtarët shqiptarë, nën drejtimin e Kanan Mazes, qëndruan brenda vijës së ujit të liqenit të Janinës për t'iu shmangur zjarrit të artilerisë armike.

Në këto përballje, Sako Sakaj tregoi guxim të rrallë. Ai arriti të kapte rob borizanin dhe tre ushtarë të ushtrisë armike, një akt që u përjetësua edhe në këngën popullore të kohës:

“Kanan Mazja foli e briti
O djem sungjit gatiti...
Në qafë të Poros matanë
Sakua një trim i rrallë
Vate zuri borizane...”


Kënga popullore, si kronikë e gjallë e historisë shqiptare, ruajti në vargje emrin dhe trimërinë e tij, duke e bërë pjesë të kujtesës kolektive të Labërisë.

Kthimi në Vlorë për mbrojtjen e Flamurit

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912,

SAKO SALI SAKAJ

Luftëtar dhe atdhetar i përpjekjeve për liri e pavarësi kombëtare



Dinjiteti moral i luftëtarëve të lirisë

Pas fitores historike të Luftës së Vlorës, më 3 shtator 1920, në Sheshin e Flamurit u organizuan festimet e çlirimit. Në ato momente, sipas kujtimeve të Sako Sakajt, pati edhe përplasje me disa agallarë të Vlorës, të cilët shfaqën përçmim ndaj luftëtarëve popullorë.

Kur ata iu drejtuan Mato Hasanit nga Brataj me fjalët: “Hajde na merr një valle”, ai iu përgjigj: **“Po mora unë një valle, ju do të ikni nga Sheshi i Flamurit”.**

Në vallen e kënduar nga Mato Hasani merrnin pjesë edhe Sako Sakaj dhe luftëtarë të ardhur nga krahinat e ndryshme të Shqipërisë. Kënga popullore e asaj dite shprehte frymën e fitores dhe krenarinë e luftëtarëve që kishin çliruar Vlorën me gjakun e tyre.

Në këtë episod del qartë edhe dimensionin moral i Sako Sakajt dhe bashkëluftëtarëve të tij: njerëz të thjeshtë, por me dinjitet të lartë, që luftuan jo për privilegje personale, por për nderin dhe lirinë e Shqipërisë.

Qëndrimi gjatë Luftës Nacionalçlirimtare

Edhe gjatë viteve të pushtimit fashist e nazist, Sako Sakaj mbeti i lidhur me çështjen kombëtare. Megjithëse në moshë më të madhe, ai vijoi të kontribuonte me autoritetin dhe përvojën e tij.

Veçanërisht domethënës mbetet debati i zhvilluar në vitin 1942 me kryeplakun e Ploçës për mbështetjen e forcave të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar apo të Ballit Kombëtar.

Me autoritetin moral që gëzonte në krahinë, Sako Sakaj ndikoi që Ploça të mbështeste luftën kundër pushtuesit në krah të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Për të, mbi çdo ndarje politike qëndronte nevoja për çlirimin e vendit.

Historia dëshmoi se zgjedhja e tij ishte në shërbim të interesit kombëtar dhe të fitores mbi pushtuesin nazifashist.

Një figurë simbol e luftëtarit popullor shqiptar

Figura e Sako Sali Sakajt mishëron tipin e luftëtarit popullor shqiptar: burrë i thjeshtë, i ndershëm, trim dhe i përkushtuar ndaj atdheut. Ai nuk kërkoi poste, privilegje apo lavdi personale. E gjithë jeta e tij ishte një shërbim në heshtje për kombin.

Kontributi i tij shtrihet në disa nga momentet më të rëndësishme të historisë moderne shqiptare: në kryengritjet për liri kombëtare; në Luftën e Janinës, në mbrojtjen e Pavarësisë së Shqipërisë, në Luftën e Vlorës dhe në mbështetjen e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kjo e bën figurën e tij pjesë të pandarë të memories historike të Labërisë dhe të patriotizmit shqiptar.

Trashëgimia që mbetet

Sot, kujtimi i Sako Sali Sakajt mbetet i gjallë në respektin e njerëzve të Ploçës dhe të gjithë atyre që njohin historinë e sakrificave shqiptare për liri.

Ai përfaqëson brezin e burrave që e deshën Shqipërinë pa kushte, që luftuan për të pa kërkuar shpërblim dhe që e mbajtën gjallë idealin kombëtar në kohët më të vështira.

Në një kohë kur historia shpesh fokusohet vetëm te figurat më të njohura, jeta e Sako Sakajt na kujton se liria dhe pavarësia e Shqipërisë u ndërtuan edhe mbi sakrificat e luftëtarëve të heshtur, njerëzve të zakonshëm me zemër të madhe dhe me besnikëri të palëkundur ndaj atdheut.

Lavdia dhe nderimi për këtë bir të Ploçës mbeten pjesë e ndërgjegjes sonë kombëtare. Kujtimi i tij është një thirrje për të ruajtur historinë, për të respektuar sakrificën dhe për të edukuar brezat e rinj me frymën e atdhedashurisë dhe të shërbimit ndaj Shqipërisë.

përbënte kulmin e aspiratave kombëtare shqiptare. Në atë kohë, batalioni vlonjat i drejtuar nga Kanan Maze ndodhej ende në frontin e Janinës. Pas mbërritjes së telegramit nga Vlora me thirrjen: **“Kthehuni në Vlorë, në mbrojtje të Flamurit”**, komandanti Kanan Maze urdhëroi menjëherë tërheqjen e trupave shqiptare drejt Vlorës. Vendimi hasi në kundërshtimin e komandës osmane, e cila urdhëroi vendosjen e mitralozëve përballë luftëtarëve shqiptarë dhe kërcënoi me hapje zjarri në rast largimi. Në ato çaste dramatike, Kanan Maze deklaroi me vendosmëri: “Në rast se do të qëlloni mbi trupat e mia, do të më qëlloni mua të parin”. Në krye të kolonës së kthimit drejt Vlorës ishte vetë Kanan Maze, i mbështetur nga Sako Sakaj dhe Azbi Cano Mavrova. Ky akt ishte jo vetëm një vendim ushtarak, por edhe një deklaram i hapur i besnikërisë ndaj shtetit shqiptar që sapo kishte lindur.

Me mbërritjen në Vlorë, Sako Sakaj dhe luftëtarët e tjerë të batalionit u caktuan në ruajtje të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, duke formuar një lloj garde besnike për mbrojtjen e institucioneve të para të shtetit shqiptar.

Lufta e Vlorës dhe heroizmi në Qafën e Koçiut

Një nga faqet më të lavdishme të jetës së Sako Sakajt lidhet me pjesëmarrjen e tij në Luftën Kombëtare të Vlorës, më 1920, ku populli shqiptar u ngrit kundër pushtimit italian.

Edhe në fazën përgatitore të luftës, ai ishte aktiv në organizimet ushtarake të drejtuara nga Kanan Maze. Më 5 qershor 1920, filloi sulmi i përgjithshëm kundër forcave italiane dhe Sako Sakaj mori pjesë në betejat më të ashpra të zhvilluara në Kotë dhe në Qafën e Koçiut.

Në kujtimet e tij ai rrëfente: “Agimi i ditës na gjeti në luftime me italianët. Në mbështetje të çetave tona në Qafën e Koçiut mbërriti edhe Selam Musai me çetën e tij dhe bëri thirrje: ‘Përpara o djem, se erdhi dhe xha Selami!’”.

Në ato çaste dramatike, artileria italiane bombardonte pa ndërprerje pozicionet shqiptare. Një predhë shpërtheu pranë luftëtarëve dhe vrau heroin Selam Musai së bashku me pesë luftëtarë të tjerë.

Kjo skenë mbeti e gdhendur në kujtesën e Sako Sakajt si simbol i sakrificës sublime për lirinë e atdheut



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

PËLLUMB MUKA, Ushtaraku serioz i Gardës së Republikës dhe biri fisnik i Labërisë

Në historinë e Forcave të Armatosura shqiptare dhe strukturave të sigurisë kombëtare ka shumë ushtarakë që kanë shërbyer me përkushtim, korrektësi dhe dinjitet, por vetëm disa prej tyre mbeten gjatë në kujtesën njerëzore për seriozitetin, karakterin dhe respektin që kanë fituar ndër vite. Një prej tyre është edhe Pëllumb Medin Muka, biri i Shkozës së Labërisë, ushtaraku i Gardës së Republikës, njeriu i thjeshtë dhe fisnik, që i ka shërbyer shtetit shqiptar me disiplinë dhe përgjegjësi, duke mbetur njëkohësisht i lidhur fort me traditat, kulturën dhe këngën labe.

Pëllumb Muka përfaqëson modelin e ushtarakut korrekt dhe të përkushtuar, por edhe të njeriut që nuk i harron rrënjët, vendlindjen dhe trashëgiminë shpirtërore të krahinës së tij. Ai është ndër ata njerëz që në çdo detyrë ku ka shërbyer kanë lënë pas respekt, mirësi dhe kujtime të mira njerëzore.

Shkoza, vatër trimërie, kulture dhe atdhedashurie

Vendlindja e Pëllumb Mukës, Shkoza e Kudhës-Gërhotit, është një nga fshatrat me histori dhe tradita të njohura të Labërisë. E vendosur mes luginës së Vjosës dhe rrëzës së malit të Kudhësit, kjo trevë ka qenë ndër shekuj një udhëkryq lidhës mes Vlorës, Tepelenës dhe Mallakastrës.

Shkoza njihet për njerëzit e saj bujarë, patriotë, arsimdashës dhe punëtorë. Ajo ka nxjerrë luftëtarë, dëshmorë, intelektualë dhe ushtarakë që kanë kontribuar për Atdheun në periudha të ndryshme historike.

Vetë Pëllumb Muka e përshkruan Shkozën si një vend ku historia, tradita dhe krenaria familjare bashkëjetojnë natyrshëm me mikpritjen dhe kulturën labe.

Nga oxhaku i Mukajve tek shërbimi ndaj Atdheut

Familja Muka është ndër oxhaqet e njohura të Shkozës, me tradita patriotike dhe pjesëmarrje aktive në luftërat dhe zhvillimet e vendit.

Babai i tij, Medin Muka, ishte pjesëtar i çetës territoriale gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe kontribuoi në mbështetjen e forcave partizane. Familja Muka ka qenë një vatër e hapur atdhëtarie dhe sakrifice.

Në këtë frymë u rrit edhe Pëllumb Muka, i lindur më 14 janar 1949 në Shkozë të Vlorës. Fëmijëria e tij përkoi me vitet e vështira të pasluftës, por edhe me edukimin patriotik dhe disiplinën familjare që karakterizonte familjet labe.

Arsimin fillor e kreu në shkollën “Kuto Besimi” në Shkozë, ndërsa më pas ndoqi shkollën 7-vjeçare “Qazim Hoxha” në Sevaster, një ndër institucionet arsimore më të njohura të zonës.

Brezi i tij u edukua me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vendit dhe respektin për dijen, punën dhe shërbimin ndaj shtetit.

Garda e Republikës, shkolla e disiplinës dhe përkushtimit

Më 12 dhjetor 1968, Pëllumb Muka iu përgjigj thirrjes për kryerjen e shërbimit ushtarak në batalionin e tretë të Gardës së Republikës, me qendër në Sauk.

Shërbimi në Gardë ishte një përgjegjësi e veçantë, që kërkonte disiplinë të lartë, korrektësi, besnikëri dhe profesionalizëm. Pikërisht në këtë strukturë Pëllumb Muka spikati për seriozitetin dhe aftësinë e tij në kryerjen e detyrave.

Pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ai vijoi rrugën e karrierës në strukturat ushtarake dhe të sigurisë.

Nga viti 1971 shërbeu në repartin ushtarak të artillerisë “Katjusha”, ndërsa nga janari 1975 deri më 4 korrik 1992 shërbeu për 17 vite në Gardën e Republikës, duke fituar respektin e kolegëve dhe drejtuesve.

Ai shërbeu në një periudhë kur Garda drejtohej nga figura të njohura si Zija Kambi, Xhafer Peçi dhe Dane Binaj.

Kolegët e kujtojnë si një ushtarak korrekt, të qetë, energjik dhe tepër të përgjegjshëm në detyrë.

Një jetë në shërbim të shtetit

Pas viteve të shërbimit në Gardën e Republikës, Pëllumb Muka vijoi kontributin e tij edhe në institucione të tjera shtetërore. Në vitet 1992–2005 shërbeu në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa më pas edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Në vitin 2006 doli në pension si ushtarak, pas një karriere të gjatë dhe të respektuar në shërbim të shtetit shqiptar. Ai mbetet një prej atyre ushtarakëve që nuk kërkuan kurrë protagonizëm, por e kryen detyrën me ndershmëri, korrektësi dhe përkushtim.



Rapsodi që ruan shpirtin e Labërisë

Përveç jetës ushtarake, Pëllumb Muka njihet edhe si këngëtar dhe rapsod i këngës labe. Ai ka mbajtur gjallë traditën dhe kulturën e krahinës së tij, duke kënduar këngët e trimërisë, atdhedashurisë dhe historisë së Labërisë. Kudo ku ka jetuar, në Shqipëri, SHBA apo Kanada, ai ka mbetur i lidhur me kulturën labe dhe me këngën tradicionale që përçon kujtesën historike dhe shpirtin e kësaj treve. Përmes këngës ai ka ruajtur jo vetëm traditën familjare, por edhe identitetin kulturor të Labërisë.

Familja, krenaria më e madhe

Pëllumb Muka është i martuar me Sanije Shahajn nga Kremenari i Mallakastrës dhe kanë ndërtuar një familje të respektuar dhe të mirë arsimuar. Djemtë e tyre, Maksim dhe Alketi, jetojnë dhe punojnë në Kanada dhe SHBA, duke ruajtur lidhjet me vendlindjen dhe traditat familjare. Edhe pse jeton mes Shqipërisë, Kanadasë dhe Amerikës, Pëllumb Muka mbetet i lidhur fort me Shkozën, Labërinë dhe Tiranën. Dashuria për familjen, nipërit dhe mbesat mbetet sot gëzimi më i madh i jetës së tij.

Shkoza dhe dëshmorët, krenari brezash

Në bisedat e tij, Pëllumb Muka ndalet shpesh tek historia e Shkozës dhe dëshmorët e saj. Ai flet me respekt të veçantë për figurën legjendare të Kanan Mazes, Heroit të Popullit dhe simbolit të Luftës së Vlorës, si dhe për dëshmorët e shumtë të fshatit që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë.

Shkoza ka dhënë një kontribut të madh në Luftën e Vlorës dhe në Luftën Nacionalçlirimtare, duke mbetur një ndër trevat me tradita të forta patriotike në Labëri.

Një figurë që meriton respekt

Pëllumb Medin Muka mbetet një figurë e respektuar e Gardës së Republikës dhe e komunitetit të tij.

Ai përfaqëson ushtarakun e përkushtuar, qytetarin e ndershëm dhe njeriun që nuk i harroi kurrë rrënjët, historinë dhe kulturën e vendlindjes.

Në jetën e tij bashkëjetojnë natyrshëm: serioziteti ushtarak, mirësia njerëzore, respekti për familjen dhe dashuria për Labërinë.

Figura të tilla janë pasuri njerëzore dhe morale për komunitetin dhe për kujtesën historike të vendit.



Kongresi i Përmetit, një moment përcaktues në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

Më 24 maj 1944, në qytetin e Përmetit, nisi punimet Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar, një nga ngjarjet më të rëndësishme politike, ushtarake dhe historike të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në historinë shqiptare ai njihet shkurt si Kongresi i Përmetit dhe konsiderohet si kuvendi që përcaktoi drejtimin final të luftës për çlirimin e vendit dhe organizimin institucional të Shqipërisë së pasluftës.

Shqipëria në pragun e kthesës historike

Viti 1944 shënonte një periudhë vendimtare për fatet e luftës antifashiste në Shqipëri. Pas përballimit të operacionit të dimrit 1943–1944, forcat dhe Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare arritën jo vetëm të mbijetonin, por edhe të konsolidoheshin si forca kryesore ushtarake kundër pushtuesve nazifashistë.

Megjithëse propaganda gjermane dhe qeveria kuislinge e kohës deklarorin se rezistenca partizane ishte shkatërruar, realiteti në terren tregonte të kundërtën. Në pranverën e vitit 1944, repartet partizane po zgjeroheshin me shpejtësi në të gjithë territorin shqiptar, ndërsa shumë të rinj e të reja iu bashkuan radhëve të luftës çlirimtare.

Në këtë klimë të re ushtarake dhe politike, drejtuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare vendosën të thërrasin një kuvend kombëtar, i cili do të bënte bilancin e luftës dhe do të përcaktonte objektivat për fazën përfundimtare të saj.

Përmeti, qyteti që priti Kongresin

Për zhvillimin e punimeve u zgjodh qyteti i Përmetit, i cili në atë kohë ishte zonë e çliruar dhe ofronte kushtet e nevojshme për organizimin e një aktiviteti të tillë kombëtar. Më 24 maj 1944, në Përmet mbërritën rreth 200 delegatë nga të gjitha trevat shqiptare. Ata përfaqësonin formacionet partizane, këshillat nacionalçlirimtare, organizatat rinore dhe të grave, si dhe shtresa të ndryshme të popullsisë. Përmetarët pritën delegatët me mikpritje dhe u angazhuan në sigurimin e mbarëvajtjes së Kongresit. Kjo ngjarje mbeti gjatë në kujtesën historike të qytetit dhe të banorëve të tij, duke u kthyer më pas në një simbol të rëndësishëm historik për Përmetin.

Një organizim me frymë përfaqësuese

Një nga elementët më domethënës të Kongresit ishte mënyra e përzgjedhjes së delegatëve. Edhe pse vendi ndodhej në kushtet e luftës, procesi i përfaqësimit u mbështet në parime të gjera pjesëmarrjeje. Në zonat e çliruara delegatët u zgjodhën në mbledhje popullore me votim të hapur, ndërsa në zonat e pushtuara ata u caktuan nga strukturat lokale nacionalçlirimtare. Në Kongres morën pjesë përfaqësues nga të gjitha krahinat e vendit, si dhe delegatë të organizatave rinore e të grave.



Kongresi i Përmetit nuk pati vetëm rëndësi politike. Ai lidhej drejtpërdrejt me zhvillimet ushtarake në terren dhe me kalimin e forcave partizane në ofensivë të përgjithshme.

Pak ditë pas përfundimit të punimeve, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së urdhëroi nisjen e ofensivës së madhe ushtarake kundër forcave gjermane dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Ky përfaqësim i gjerë i dha Kongresit karakterin e një kuvendi kombëtar, i cili synonte të shprehte vullnetin politik dhe ushtarak të forcave që drejtonin luftën antifashiste në Shqipëri.

Vendimet kryesore të Kongresit

Punimet e Kongresit të Përmetit zgjatën disa ditë dhe prodhuan vendime me rëndësi të madhe për organizimin institucional të vendit dhe vazhdimin e luftës. Kongresi zgjodhi fillimisht Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar si organin më të lartë përfaqësues dhe ligjvënës të kohës. Ky këshill krijoi më pas kryesinë e vet drejtuese, në krye të së cilës u vendos Omer Nishani. Gjithashtu, u krijua Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të ushtronte funksionet e një qeverie provizore deri në përfundimin e luftës. Në krye të tij u vendos Enver Hoxha, ndërsa Myslim Peza u emërua nënkryetar. Ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit përmenden, vazhdimi i luftës deri në çlirimin e plotë të vendit, ndërtimi i një Shqipërie të lirë dhe sovraane pas luftës, mosnjohja e çdo qeverie që do të krijohet jashtë vullnetit të popullit shqiptar, organizimi i pushtetit të ri në territoret e çliruara. Këto vendime përcaktuan drejtimin politik dhe institucional që do të ndiqte Shqipëria në fundin e Luftës së Dytë Botërore.

Rëndësia ushtarake e Kongresit

Kongresi i Përmetit nuk pati vetëm rëndësi politike. Ai lidhej drejtpërdrejt me zhvillimet ushtarake në terren dhe me kalimin e forcave partizane në ofensivë të përgjithshme. Pak ditë pas përfundimit të punimeve, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së urdhëroi nisjen e ofensivës së madhe ushtarake kundër forcave gjermane dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Në këtë kuadër, formacionet partizane kaluan nga lufta

mbrojtëse në operacione të gjera sulmuese në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Marshimi i Divizionit të Parë Sulmues drejt veriut konsiderohet një nga momentet kyçe të etapës përfundimtare të luftës për çlirimin e vendit.

Kjo tregoi se forcat nacionalçlirimtare tashmë kishin fituar iniciativën strategjike dhe ishin të afta të operonin në të gjithë territorin shqiptar.

Kongresi në kujtesën historike shqiptare

Pas përfundimit të luftës, Kongresi i Përmetit zuri një vend të rëndësishëm në historinë moderne shqiptare. Për dekada me radhë ai u përkujtua si një prej momenteve themelore të organizimit politik dhe ushtarak gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Për qytetin e Përmetit, 24 maji mbeti një datë simbolike dhe pjesë e identitetit historik lokal. Çdo vit zhvilloheshin aktivitete përkujtimore në nder të Kongresit dhe të pjesëmarrësve të tij. Sot, Kongresi i Përmetit studiohet si një ngjarje me rëndësi të veçantë historike, e lidhur me etapën finale të luftës kundër pushtimit nazifashist dhe me krijimin e institucioneve të para shqiptare në fundin e Luftës së Dytë Botërore.

Një ngjarje që mbetet pjesë e historisë kombëtare

Mbi tetë dekada pas zhvillimit të tij, Kongresi i Përmetit vazhdon të konsiderohet një pikë kulmore e historisë shqiptare të shekullit XX. Ai përfaqëson një moment ku lufta antifashiste, organizimi institucional dhe përpjekjet për çlirimin e vendit u bashkuan në një platformë të vetme kombëtare. Pavarësisht interpretimeve të ndryshme historike që janë bërë ndër vite, rëndësia e Kongresit mbetet e lidhur me rolin që ai pati në organizimin e rezistencës shqiptare dhe në përcaktimin e etapës përfundimtare të luftës për çlirimin e Shqipërisë.



Shërbimi VPN i paraqitur në pothuajse çdo hetim të madh të krimit kibernetik të mbështetur nga Europol

Një shërbim VPN i përdorur nga kriminelët kibernetikë për të fshehur sulmet me ransomware, vjedhjen e të dhënave dhe vepra të tjera të rënda penale është çmontuar në një operacion ndërkombëtar të udhëhequr nga Franca dhe Holanda, me mbështetjen e Europol dhe Eurojust.

Për vite me radhë, shërbimi, i njohur si 'First VPN', u promovua në forumet rusisht-folëse të krimit kibernetik si një mjet i besueshëm për të qëndruar larg mundësive të zbatimit të ligjit. Ai u ofronte përdoruesve pagesa anonime, infrastrukturë të fshehur dhe shërbime të projektuara posaçërisht për përdorim kriminal.

'First VPN' ishte ngulitur thellë në ekosistemin e krimit kibernetik, duke u shfaqur në pothuajse çdo hetim të madh të krimit kibernetik të mbështetur nga Europol në vitet e fundit. Kriminelët e përdorën atë për të fshehur identitetin dhe infrastrukturën e tyre gjatë kryerjes së sulmeve ransomware, mashtrimeve në shkallë të gjerë, vjedhjes së të dhënave dhe veprave të tjera të rënda penale.

"Për vite me radhë, kriminelët kibernetikë e panë këtë shërbim VPN si një portë drejt anonimitetit. Ata besonin se do t'i mbante larg zbatimit të ligjit. Ky operacion i vërteton se e kanë gabim. Heqja e tij jashtë linje heq një shtresë kritike mbrojtjeje nga e cila kriminelët mbështeteshin për të vepruar, komunikuar dhe për t'iu shmangur zbatimit të ligjit", - Kreu i Qendrës Evropiane të Krimit Kibernetik të Europolit Edvardas Šileris.

Autoritetet arrestojnë administratorin dhe çmontojnë infrastrukturën

Veprimi i koordinuar u zhvillua midis 19 dhe 20 majit dhe shënjestroi infrastrukturën pas një prej shërbimeve VPN më të përdorura gjerësisht në nëntokën e krimit kibernetik.

Gjatë ditëve të aksionit, autoritetet: intervistuan administratorin dhe kryen një kontroll shtëpie në Ukrainë; çmontuan 33 servera të lidhur me shërbimin kriminal dhe prishën infrastrukturën e përdorur për të mbështetur aktivitetin kibernetik kriminal në të gjithë botën.

Emrat e domeneve të synuara janë mbyllur falë bashkëpunimit të përbashkët ndërkombëtar të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit me emrat e mëposhtëm të domeneve të sekuestruara:

1vpns.com,
1vpns.net,
1vpns.org,
Domene të lidhura onion.

Përdoruesit e shërbimit kriminal janë njoftuar për mbylljen dhe janë informuar se janë identifikuar.

Hetuesit identifikuan mijëra përdorues të lidhur me aktivitetin e krimit kibernetik

Heqja vjen pas një hetimi të nisur në dhjetor 2021.

VPN kriminale kibernetike e përdorur nga aktorët e ransomware çmontohet në një goditje globale

Duke punuar me Qendrën Evropiane të Krimit Kibernetik të Europolit, hetuesit fituan akses në shërbim, morën bazën e të dhënave të përdoruesve të tij dhe identifikuan lidhjet VPN të përdorura nga kriminelët kibernetikë që kërkonin të fshehin aktivitetet e tyre. Operacioni përfitoi gjithashtu nga mbështetja e ofruar nga partneri i sigurisë kibernetike Bitdefender përmes Europolit.

Inteligjenca e mbledhur ekspozoi mijëra përdorues të lidhur me ekosistemin e krimit kibernetik dhe gjeneroi pista operacionale të lidhura me sulme ransomware, skema mashtrimi dhe vepra të tjera të rënda penale në të gjithë botën.

Informacion i ndarë në të gjithë botën për të mbështetur hetimet në vazhdim

Një ekip i përbashkët hetimor u krijua me mbështetjen e Eurojust në nëntor 2023, duke u mundësuar autoriteteve franceze dhe holandeze të bashkëpunojnë ngushtë, të shkëmbejnë prova dhe informacione dhe të vendosin për një strategji prokuroriale. Eurojust organizoi 16 takime koordinimi midis autoriteteve të përfshira për t'u përgatitur për ditën e veprimit të përbashkët që po zhvillohet këtë javë, duke nënvizuar nevojën për bashkëpunim kompleks gjyqësor.

Ky organizim u pasqyrua nga një Task Forcë Operacionale (OTF) e krijuar në Europol, e cila mblodhi hetues nga 16 vende për të analizuar të dhënat e sekuestruara dhe për të koordinuar ndarjen e inteligjencës me partnerët ndërkombëtarë. Task Forca e Përbashkët e Veprimit Kundër Krimit Kibernetik (J-CAT) e organizuar në Europol gjithashtu mbështeti përpjekjet e koordinimit, ndërlidhjes dhe dekonfликтit me autoritetet kombëtare.

Operacioni ka gjeneruar tashmë rezultate të rëndësishme operative në nivelin e Europol: 83 paketa inteligjence të shpërndara; informacione të lidhura me 506 përdorues të ndara ndërkombëtarisht; 21 hetime të mbështetura nga Europol u përparuan përmes inteligjencës së marrë.

Me infrastrukturën e çmontuar dhe administratorin nën arrest, hetuesit në juridiksione të shumta tani po përdorin

inteligjencën e mbledhur për të mbështetur hetimet e vazhdueshme të krimit kibernetik në të gjithë botën.

Dita e veprimit u krye nga autoritetet e mëposhtme:

Francë: Prokuroria e Parisit (J3) dhe gjyqtari hetues i Parisit; Njësia e Krimit Kibernetik e Gjykatës së Parisit dhe Njësia e Krimit Kibernetik e Prefekturës së Policisë (BL2C); Njësia Qendrore e Krimit Kibernetik (OFAC);

Holandë: Zyra e Prokurorit Publik Kombëtar; Ekipi i Krimit të Teknologjisë së Lartë i Njesisë Kombëtare të Hetimit;

Luksemburg: Zyra e Prokurorisë së Qarkut; Policia Gjyqësore e Luksemburgut;

Rumani: Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit; Drejtoria për Luftimin e Krimit të Organizuar, Policia Rumune;

Zvicër: Zyra e Prokurorit Publik të Cyrihut III; Policia Kantonale e Cyrihut;

Ukrainë: Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës; Departamenti Kibernetik i Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës (SBU); Departamenti Kryesor i Hetimit i Policisë Kombëtare të Ukrainës; Divizioni për Luftimin e Krimeve të Sigurisë Kibernetike;

Mbretëria e Bashkuar: Agjencia Kombëtare e Krimit – Njësia Kombëtare e Krimit Kibernetik.

Vendet pjesëmarrëse në ditët e veprimit

Luksemburgu, Zvicra, Rumania, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar

Vendet që mbështesin hetimin

Kanadaja, Gjermania, Rumania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vendet e mëposhtme punuan me të dhënat e sekuestruara: Vendet që mbështesin OTF-në e Europolit; Spanja, Suedia

Vendet pjesëmarrëse në OTF-në e Europolit

Kanadaja, Danimarka, Estonia, Franca, Letonia, Lituania, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Zvicra, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Berlin, maj 2026 – Gjermania ka prezantuar një risi madhore që pritet të ndryshojë mënyrën e zhvillimit të luftimeve tokësore: integrimin e raketës anti-tank ENFORCER mbi robotin tokësor pa pilot GEREON UGV. Ky kombinim u shfaq për herë të parë në panairin e sigurisë dhe mbrojtjes Enforce TAC 2026, duke u cilësuar si një hap i rëndësishëm drejt epokës së luftës tokësore robotike.

Një revolucion në fushëbetejë

Raketa ENFORCER, e zhvilluar nga kompania MBDA Deutschland, është projektuar për të neutralizuar mjetet e blinduara me saktësi të lartë. Me peshë vetëm 7 kilogramë, ajo është e lehtë për t'u transportuar dhe përdorur nga këmbësoria ose nga platforma të automatizuara. Rrezja efektive arrin deri në 2 kilometra, duke e bërë një armë ideale për operacione urbane dhe luftime në terrene të vështira.

Një nga veçoritë më të rëndësishme është sistemi “soft-launch”, i cili lejon nisjen e raketës pa prodhuar flakë të forta pas-shpërthimi, duke e bërë të sigurt përdorimin në hapësira të kufizuara. Për më tepër, raketa është e pajisur me sistem drejtimi elektro-optik dhe infra të kuqe, që i jep aftësi “fire-and-forget”: pasi lëshohet, ajo ndjek objektivin pa pasur nevojë për kontroll të vazhdueshëm nga operatori. Ky kombinim i teknologjisë e bën ENFORCER një armë të besueshme për misione precize, ditën dhe natën.

GEREON UGV – roboti që lufton

GEREON UGV, i zhvilluar nga ARX Robotics, është një platformë tokësore pa pilot e aftë të kryejë misione të ndryshme: nga transporti i pajisjeve dhe zbulimi, deri tek operacionet sulmuese. Në konfigurimin e ri, roboti është pajisur me katër lëshues ENFORCER, duke e shndërruar në një armë të fuqishme kundër mjeteve të blinduara.

Ky integrim e bën GEREON një mjet fleksibël dhe të shumëfunksional, i aftë të përshtatet sipas nevojave të fushëbetejës. Ai mund të operojë në mënyrë autonome ose të kontrollohet nga distanca, duke reduktuar rrezikun për trupat gjermanë. Për më tepër, GEREON është projektuar të funksionojë në kuadër të konceptit “Manned-Unmanned Teaming”, ku forcat njerëzore bashkëpunojnë me robotët për të rritur efikasitetin dhe sigurinë.

Avantazhet strategjike

Integrimi i ENFORCER mbi GEREON sjell një sërë avantazhesh:

- Mbrojtje e trupave: robotët kryejnë sulme pa ekspozuar ushtarët ndaj rrezikut direkt.
- Goditje precize ditën dhe natën: falë sistemit elektro-optik të raketës ENFORCER.
- Fleksibilitet i lartë: GEREON mund të përshtatet për role të ndryshme, nga logjistika tek sulmet.
- Përshtatje për mjedise urbane: nisja e butë e raketës e bën të sigurt përdorimin në hapësira të kufizuara.
- Integrim në konceptin “Manned-Unmanned Teaming”: bashkëpunim mes forcave njerëzore dhe robotëve për efikasitet maksimal.

Ky kombinim i teknologjisë së avancuar me robotikën e armatosur përfaqëson një ndryshim të madh në mënyrën se si mund të zhvillohen konfliktet e së ardhmes.

Impakti ndërkombëtar

Ekspertët e mbrojtjes e shohin këtë zhvillim si një hap drejt luftës tokësore robotike, ku automjetet pa pilot do të marrin një rol gjithnjë e më të madh në operacionet ushtarake. Gjermania, me këtë inovacion, pozicionohet si një nga liderët në fushën e robotikës së armatosur, duke ndjekur trendin global ku SHBA, Turqia dhe Kina po investojnë fort në sisteme të ngjashme.

Ky prezantim është gjithashtu një mesazh politik: Gjermania synon të forcojë rolin e saj brenda NATO-s dhe të tregojë se është e gatshme të kontribuojë me teknologji të avancuar në mbrojtjen kolektive. Në një kohë kur tensionet globale po rriten, ky hap

Gjermania prezanton robotin luftarak **GEREON** me raketën **ENFORCER**



GEREON UGV, i zhvilluar nga ARX Robotics, është një platformë tokësore pa pilot e aftë të kryejë misione të ndryshme: nga transporti i pajisjeve dhe zbulimi, deri tek operacionet sulmuese. Në konfigurimin e ri, roboti është pajisur me katër lëshues ENFORCER, duke e shndërruar në një armë të fuqishme kundër mjeteve të blinduara.

shihet si një përpjekje për të balancuar fuqinë ushtarake dhe për të garantuar sigurinë e aleatëve.

Sfida dhe dilema

Megjithatë, përdorimi i robotëve të armatosur ngre pyetje të rëndësishme etike dhe ligjore. Kush mban përgjegjësi për një sulm të kryer nga një sistem autonom? Si mund të parandalohet përdorimi i tyre në mënyrë të pakontrolluar?

- Përveç dilemave etike, ekzistojnë edhe sfida praktike:
- Kosto e lartë për zhvillim dhe mirëmbajtje.
 - Varësia nga teknologjia: rrezik në rast sulmesh kibernetike.
 - Balanca strategjike: shtetet e tjera mund të ndihen të detyruara të zhvillojnë sisteme të ngjashme, duke nxitur garë armatimesh.

Këto dilema pritet të diskutohen gjerësisht në forumet ndërkombëtare të sigurisë, ku Gjermania do të duhet të japë shpjegime mbi mënyrën e përdorimit dhe kontrollit të këtyre sistemeve.

Integrimi i raketës ENFORCER mbi robotin GEREON UGV është një risi konkrete dhe madhore që tregon drejtimin e ri të teknologjisë ushtarake gjermane. Ky kombinim i robotikës me armë precize jo vetëm që rrit fuqinë goditëse të ushtrisë, por edhe hap një kapitull të ri në mënyrën se si do të zhvillohen konfliktet e së ardhmes.

Gjermania ka dhënë një mesazh të qartë: lufta e së ardhmes do të jetë e automatizuar, e saktë dhe e drejtuar nga teknologjia. Ky zhvillim nuk është thjesht një inovacion teknik, por një deklaratë strategjike që vendos Gjermaninë në pararojë të transformimit të luftës moderne.



HAPEN APLIKIMET PËR STUDIME USHTARAKE BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Qendra e Personel Rekrutimit fton të rinjtë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Nëse synoni një karrierë profesionale në Forcat e Armatosura dhe dëshironi të studioni në akademi prestigjioze ushtarake brenda dhe jashtë vendit, Qendra e Personel Rekrutimit hap aplikimet për vitin akademik 2026–2027.

STUDIME NË QENDRËN E STUDIMEVE UNIVERSITARE NË KOSOVË

Qendra e Personel Rekrutimit do të rekrutojë:

1 (një) kandidat për studime në

Qendrën e Studimeve Universitare në Kosovë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit: 29 maj 2026

Dokumentacioni dorëzohet pranë: Qendrës së Personel Rekrutimit

Për informacion:

 **00355 42 348 588**

WhatsApp: +355 68 340 4896

Detaje të plota:
Qendra e Personel
Rekrutimit – Studime
në Kosovë

<https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/studente-brenda-jashte-vendit/7789-qendra-e-personel-rekrutimit-do-te-rekrutoje-1-nje-kandidat-per-studime-ne-qendren-e-studimeve-universitare-ne-kosove>

HAPEN APLIKIMET PËR AKADEMITË USHTARAKE TË ITALISË Akademia Detare Livorno

Kuota studimi:

1 (një) kuotë në degën “Inxhinieri Navale”

Afati i aplikimit:

26 maj 2026

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë:

Qendrës së Personel Rekrutimit

Për informacion: **00355 42 348 588**

WhatsApp: **+355 68 340 4896**

Informacion i plotë: Akademitë Ushtarake të Italisë – Detajet e aplikimit

FORCAT E ARMATOSURA

Informacion i plotë:
urlkub.co/NmsLNz

Edukim. Disiplinë. Profesionalizëm. Karrierë.

BËHU PJESË E ELITËS USHTARAKE SHQIPTARE

DHE NDËRTO TË ARDHMEN TËNDE NË SHËRBBIM
TË VENDIT DHE ALEANCËS ATLANTIKE.